

GËZIM TUSHI
QYTETI DHE PATOLOGJITË E JETËS URBANE
STUDIM

BOTIMET TOENA

GËZIM TUSHI

QYTETI DHE PATOLOGJITË
E
JETËS URBANE

studim

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Një falënderim të veçantë për Kryetarin e Bashkisë të Vlorës, Dr. Ditan Leli, dhe Këshillin Bashkiak të këtij qyteti, të cilët bënë të mundur botimin e këtij libri!

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Arlinda Rrushi, Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-41-1

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara, nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollesha”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Profesor Bedri Dedjes...

Ka qenë dëshirë e hershme, që një nga librat e mi t'ia kushtoj veprës, kontributit pedagogjik dhe letrar kombëtar të prof. Bedri Dedjes. Mendova se do të ishte më mirë që këtë ta bëja si dedikim për librin që keni në duar, i cili bën fjalë për qytetin dhe problemet e jetës urbane.

Kulturën e gjerë, imazhin, idetë, frazën dhe elokuencën brilante të prof. Bedriut e kisha parasysh që nga faqja e parë e deri tek e fundit kur punoja me këtë libër. Ndihem krenar që tani kam dhënë edhe unë kontributin tim modest në përjetësimin e jetës dhe veprës së këtij njeriu të madh, edukator, shkencëtar dhe kulturolog, nga më të shquarit e vendit tonë.

Por dua të jem i sinqertë. Kam edhe një arsye personale për ta bërë këtë dedikim të merituar. Sepse mua, personalisht, por jo vetëm mua (ai ishte njeri human, që i donte të gjithë), prof. Bedriu më ka dashur, më ka përkrahur, më ka nxitur dhe, mbi të gjitha, më ka mësuar si të ndërtoj një libër me lëndë, me analiza, me vëzhgime dhe me sfond të gjerë social. Është njeriu që, me mjeshtëri të rrallë shkencore, letrare dhe pedagogjike, më injektoi me elegancë dashurinë për psikologjinë sociale.

Edhe sot, por edhe sa të jem gjallë, në vetëdijen time tingëllon zëri i ëmbël, argumentimi mbushamendës, autoriteti shkencor personal i patundur, mirësia, humanizmi i këtij burri dhe shkencëtarit të shquar!

Gëzim TUSHI

Parathënie

Për shumë arsye personale, sociale, por edhe miqësore, më erdhi mirë kërkesa që të mund të shkruaja parathënien e këtij libri. Ndoshta edhe pse “lënda” e tij është fort e lidhur me misionin dhe detyrën time si kryetar bashkie. Por, pavarësisht këtyre motiveve “miqësore” dhe “zyrtare”, më duhet të pranoj se libri “Qyteti dhe patologjitë e jetës urbane” është një kontribut social dhe punë serioze individuale, pa dyshim me vlera, e sociologut vlonjat Gëzim Tushi (Mjeshtër i Madh).

Në qendër të librit vendosen problemet e qytetit, të jetës së përbashkët qytetare, duke i parë dhe vlerësuar me optikën e sociologut. Të gjitha këto e bëjnë librin një “manual” që të ndihmon në perceptimin e zhvillimeve dinamike të qytetit dhe problematikave komplekse të jetës urbane.

Është rezultat i angazhimit qytetar dhe intelektual dhe, pa dyshim, edhe i një veprimtarie e pune studimore këmbëngulëse disavjeçare. Nuk është vetëm libër me dimension teorik dhe me synime intelektuale e sociologjike, sepse lënda, përmbajtja dhe struktura e librit është ndërtuar në mënyrë të tillë, ku të reflektohen jo vetëm ide sintetike, që janë produkt i shumë analizave e refleksioneve personale të autorit, por dhe synimi për të ndikuar në trajtë etike e empirike për të gjitha problemet e zhvillimit të qytetit, përmirësimit të statusit të qytetarit dhe dinamikës së jetës urbane. Ide dhe njohuri që janë aktuale, pikërisht tani që ndodhemi në “zemër” të epokës tranzitore demokratike në vendin tonë.

Personalisht, e konsideroj me vlerë këtë libër, sepse bën të mundur dhe ndihmon qytetarët për të kuptuar të gjithë idenë e njohur, se

organizimi i qytetit dhe funksionimi i jetës urbane duhet të jenë qëllimet e para dhe të fundit të qytetarit. Nga ana tjetër, “të mendosh qytetin, do të thotë të mendosh banorin e tij ose, më saktë, për shumësinë e banorëve”, sikurse ka thënë me të drejtë sociologu i shquar Zygmunt Bauman.

Në libër ka shumë hapësirë në trajtesat që tregojnë se sot, si kurrë më parë, për shkak të zhvillimeve demografike ekstensive dhe ndryshimeve të thella sociale intensive, është bërë evidente beteja sociale për ta bërë urbanizimin e qyteteve një proces që t’i ndihmojë ato mjedise të bëhen sa më të jetueshme, duke shmangur konceptin e deformuar të qytetit, që reduktohet në një “oficinë të stërmadhe” njerëzore me “dy pamje”, por edhe me cilësi të ulët jetese urbane.

Ideja e autorit, se në kohën postmoderne “duhen teknika të reja sociologjike për të trajtuar sëmundjet e shkaktuara nga procesi i qytetërimit postmodern”, është shumë e vërtetë dhe realisht e prekshme, sepse zhvillimet e jetës urbane, në mënyra të natyrshme, por dhe paradoksale, kanë sjellë shqetësime të shumta sociale të natyrave dhe llojeve nga më të ndryshmet. Si sociolog, Gëzim Tushi mendon se duhen ide, kurajë qytetare, mendim intelektual dhe qytetar modern për të njohur, kuptuar, interpretuar dhe zgjidhur drejt shqetësimet strategjike, problemet e përditshme të organizimit të shëndetshëm dhe rrjedhjes së lirë të jetës urbane. Por kjo, sikurse mendon autori me të drejtë, mund të bëhet duke u përballur me shumë patologji sociale e urbane që janë në zgjerim. Autori jo vetëm e ka shtruar problemin, por bën edhe arsyetime e rekomandime për të bërë të mundur që “patologjitë” e jetës urbane të mbahen nën kontrollin e shoqërisë.

Situatat që zhvillohen, duke qenë jashtë kontrollit, kanë sjellë idenë se qytetet kanë marrë tatëpjetën, jeta në to po bëhet problematike dhe e padurueshme për shkak të dhunës, krimin, kaosit social, dimensioneve të zgjeruara të frikës dhe izolimit social. Është jashtë çdo dyshimi që zhvillimet e kohëve të fundit në Shqipëri kanë qenë të tilla dhe kanë ndikuar në transformimin e strukturës urbane, sociale e demografike

të qyteteve tona. Kjo është e natyrshme të ndodhë në kushtet e sotme të përfshirjes së qyteteve dhe jetës qytetare në një varg të gjatë ndryshimesh sasiore e cilësore, përmes përjetimit të proceseve intensive të ridimensionimit demografik, ndryshimit të përshpejtuar të raporteve midis popullsisë rurale e urbane, duke ecur me shpejtësi në favor të kësaj të fundit.

Në fund të fundit, është e natyrshme që autori vëmendjen dhe optikën e vlerësimit të ndryshimeve, që kanë ndodhur dhe vazhdojnë të ndodhin, e përqendron me përparësi te vlerësimi i situatave konkrete të zhvillimit dhe te transformimet e thella që ndodhin përditë në qytetet tona. Është fare i qartë konkluzioni se ndryshimet, transformimet, përmirësimet, por edhe disa përkeqësime në cilësinë e jetës urbane në qytet, duhen vlerësuar në kuadrin e shpërthimit të “revolucionit urban”, që tashmë është i pranishëm në jetën e qyteteve tona, i vazhduar dhe i pandërprerë.

Analiza e problemeve të organizimit të qytetit dhe e turbulencave të forta të jetës qytetare duhen llogaritur duke marrë parasysh dimensionet e reja të lëvizshmërisë qytetare. Pa dyshim, jemi përballë dukurisë masive të migracionit të brendshëm dhe efekteve shpërthyesë që ka ai mbi “strukturat e qytetit”. Nuk është rastësi që kësaj dukurie komplekse demografike, sociale, ekonomike e kulturore autori i kushton një pjesë të mirë të librit të tij.

Lëvizshmëria demografike dhe heterogjeniteti urban i qyteteve tona është një dukuri tipike, që shfaqet me dimension universal. Problemi është si mund të menaxhohen “konfliktet”, që lindin nga këto zhvillime, shpeshherë kaotike dhe, mbi të gjitha, si mund të sigurohet uniteti midis zgjerimit eruptiv të dimensioneve të qytetit dhe nevojës së sigurimit të kushteve për bashkëjetesë urbane harmonike e të qytetëruar të banorëve të saj. Të ardhur apo autoktonë qofshin.

Në këtë kontekst është me vlerë trajtimi që i bën autori dukurisë së shfaqjes në disa raste të egoizmit të “qytetarit autokton” ndaj atij që në emër të së drejtës së lëvizjes së lirë është i ardhur vonë nga

fshati në qytet. Titulli “qytetar” nuk është cilësi domosdoshmërisht e lidhur me origjinën, kushtet gjeografike të jetës, nuk është as cilësi e trashëguar, por atribut i fituar nga cilido njeri, nëpërmjet mënyrës së sjelljes e qëndrimit individual me qytetin dhe përshtatjen me kushtet e jetës urbane.

Akumulimi urban dhe zgjerimi i “këmishës” së qyteteve tona, si dukuri e zgjeruar, mund të bëhet i përbalueshëm, i asimilueshëm qytetarisht vetëm përmes realizimit të kushteve të natyrshme, respektimit nga kushdo i “disiplinës urbane”, ku mund të natyralizohen “diferencat” midis autoktonëve dhe qytetarëve të sapourbanizuar.

Megjithatë, qyteti dhe jeta urbane sot ka prirje të fortë për t’u dominuar nga njeriu i dehumanizuar, nga qytetari i vetmuar asocial, njeriu me sjellje harbute, i paedukuar, i vrazhdë. Njerëz të tillë përpiqen t’i japin tonin modelit të sotëm të jetës urbane dhe kërkojnë që kundërkultura e deformuar e dhunës, indiferentizmit, asocialitetit, antihumanizmit dhe kundër solidaritetit social të bëhen “kulturë sunduese” e jetës së sotme urbane, pra fizionomi e qyteteve tona. Kjo ka bërë që densiteti dhe intensiteti në rritje i njerëzve asocialë të asfiksojë dimensionet e jetës së qytetëruar, atë të njeriut human e social.

Kjo situatë ka bërë që prania e njerëzve të mirë në jetën sociale, të mos duket ose të mos bjerë në sy, megjithëse në jetën tonë sociale ata nuk mungojnë. Nuk mungojnë prindërit e mirë, të qeshur dhe edukator të mirë, mësuesit dhe mjekët e talentuar e humanë, fqinjët e komunikueshëm e me sociabilitet të spikatur, njerëzit që luajnë rolin e mikpritësit anonim të njeriut në situatë nevojë. Por raportet midis këtyre dy kategorive të njerëzve që “banojnë në qytet”, në të njëjtin habitat urban, por që janë tipikisht të ndryshëm nga njëri-tjetri, kanë marrë drejtim të përkeqësuar.

Kjo sepse, ndërkohë që njerëzit e mirë, qytetarët me staturë urbane, janë pakësuar apo sikurse thonë sociologët, po bëhen “specie në zhdukje”, po shtohen njerëzit e deformuar edukativisht e qytetarisht, të cilët po e bëjnë qytetin dhe jetën urbane një mjedis të përshtatshëm

për sjellje agresive, johumane e, pse jo, edhe antinjerëzore. Qyteti postmodern dhe jeta urbane që zhvillohet në të, po kalojnë turbulenca e probleme të rënda sociale e funksionale, sepse në të gjitha strukturat e saj po shtohen njerëzit “pasionantë” të krimit apo qytetarë të deformuar, që bëjnë krime me gjak të ftohtë.

Në këto kushte, autori ngul këmbë me të drejtë se kultura qytetare është kusht ekzistencial për ta mbrojtur jetën qytetare nga transformimet shqetësuese që mund të kenë ndikim në thellimin e paqëndrueshmërisë së jetës urbane. Nuk është qytetar i mirë ai që mendon vetëm për të drejtat e tij dhe nëpërkëmb të drejtën e të tjerëve, që janë bashkëqytetarë dhe jetojnë në të njëjtin qytet. Qyteti ka nevojë për dinjitetin e jetës së përditshme të të gjithë qytetarëve të tij.

Qyteti nuk është “pronë” e disa njerëzve, qofshin këta të njohur, persona publikë ose të pasur qofshin. Ata janë pak. Qyteti është për të gjithë qytetarët, ndryshe ai nuk do të kishte vlerë dhe qytetërimi që zhvillohet në të nuk do të ishte i shëndetshëm. Autori ngul këmbë në idenë progresive se qytetar mund të jetë ai që respekton qytetin, të tjerët dhe, mbi të gjitha, ai që zotëron dhe zbaton kërkesat qytetare të “arsyes publike”, që ndërton relacione sociale dhe krijon lidhje humane me bashkëqytetarët e tjerë. Kjo është mënyra që në qytet të mund të ndërtojmë jetën qytetare dhe të qytetëruar, pra mund të shmangim dhe të “paralizojmë” të keqen, dhe të bëhemi sa më të njerëzishëm. Qyteti, që të ketë të ardhme, ka nevojë që në habitatin e tij të ketë sa më shumë qytetarë dhe sa më pak njerëz që janë banorë thjesht biologjikë të tij.

E themi këtë, sepse është fare e vërtetë, që në jetën qytetare janë shtuar qytetarët herë egoistë e herë shirxhinj dhe indiferentë. Ata shpesh shfaqen si qenie biologjike, janë në “listat urbane” të qytetarëve, por në shumicën e rasteve mbeten qenie me identitet të fshehur qytetar.

Ka një aksiomë të vjetër në raportet midis qytetit, pushtetit lokal dhe qytetarit, sipas së cilës është e nevojshme dhe duhet të bëhet e mundur të bashkohen në një: *Qytetari* dhe *Ndërgjegjja Qytetare*. Madje, kjo filozofi duhet të përhapet në segmente sa më të gjera të jetës së qytetit.

Ideja është se mbarëvajtja e punëve të një qyteti modern asnjëherë nuk mund të bëhet vetëm me angazhimin strategjik të pushtetit lokal, të strukturave funksionale të bashkisë, pa pasur përkrah një qytetar aktiv dhe jo një egoist të vogël, njeri që e ka të skalitur në qenien e vet “shpirtin publik” dhe ndjenjën urbane.

Unë besoj, se është momenti që ta bëjmë filozofi të jetës qytetare dhe jetës së kulturuar në qytet, idenë se ato mund të shëndoshen nëse në mënyrë organike respektojmë rregullat e sjelljes qytetare. Kjo është e domosdoshme, sepse nuk mund të ketë qytet të mirë nëse qytetarët e tij nuk pranojnë të zbatojnë një mori të caktuar të normave të përbashkëta sociale, ndërsa bashkia asnjëherë nuk mund t’i kryejë ato detyra që janë ekskluzivisht të qytetarit. Kjo është arsyeja pse të gjithë duhet t’i mëshojmë forcimit të ndjenjës së “besimit qytetar” te vetja dhe te qyteti ku jetojmë. E përkthyer akoma më thjeshtë, kjo do të thotë që punët e qytetit dhe cilësia e jetës qytetare nuk mund të realizohen pa praninë e qytetarit që ka unitetin brenda vetes, që është njeri sinqerisht i shqetësuar për mbarëvajtjen e punëve në qytetin e tij. Kjo do të thotë, që detyrat e bashkisë duhet të jenë kompakte, me një ndjenjë të zgjeruar të “përgjegjësisë qytetare”. Ky unitet është i pashmangshëm në kushtet e jetës dhe të qytetit modern!

Dr. Dritan LELI
Kryetar i Bashkisë Vlorë

KAPITULLI I PARË

ZGJERIMI I QYTETEVE DHE TOLERANCA URBANE

Jeta urbane dhe qyteti me “dy pamje”

Është e vërtetë që hapësirat e qyteteve tona u “liberalizuan” dhe, në njëfarë mënyre, u bënë të mundshme si hapësira të lira jetike e qytetare për të gjithë shqiptarët. Deviza publike e lëvizjes së lirë dhe liria e lëvizjes së garantuar u bënë kuintesenca e “ideologjisë urbane”, filozofi zotëruese e mënyrës së re të riorganizimit urban të jetës demokratike dhe fizionomisë së shoqërisë postmoderne shqiptare. Por, si gjithnjë, çdo gjë e mirë ka dhe anën e saj të errët.

Nëse shumë shqiptarë e bënë të mundur largimin nga jeta e mjerueshme dhe varfëria, për shkak të mungesës së kushteve për një jetë urbane e kulturore me mirëqenie dhe të qytetëruar, kjo është një arritje madhore, edhe pse e shoqëruar me probleme sociale dhe me mangësi ligjore, të cilat kanë sjellë një lloj kaosi urban në riformatimin e qyteteve tona.

Pa dyshim, nuk do të ishte e saktë dhe aspak dobiprurëse nëse situatën e qyteteve shqiptare, që tashmë janë bërë me “dy pamje”, si edhe cilësinë e jetës së popullsisë që jetojnë në to, do ta shihnim në grup, pa bërë prerje, analiza të diferencuara dhe dallime të mënyrave individuale të organizimit dhe funksionimit të jetës së familjeve dhe individëve që jetojnë në to. Do të ishte qëndrim jonormal, pse jo edhe i ndikuar nga mentaliteti i “racizmit pa racë”, shikimi i unifikuar i situatës së “qytetit me dy pamje”, nivelimi i tipologjisë së problemeve thelbësore dhe rastësore, që shqetësojnë jetën urbane. Bashkë me ekzistencën e padyshimtë të problemeve urbane të qytetit me “dy pamje”, është dhe problemi social e demografik që lidhet me një lloj statusi të diferencuar të qytetarit “de jure” dhe atij “de facto”.

Nuk është normale që gjykimi për problematikat urbane të qytetit me “dy pamje” dhe gjykimi i problemeve sociale-ekonomike të banorëve që jetojnë në to, të bëhet i paragjykuar, i diferencuar artificialisht. Sepse, herë pas herë, në analizat politike dhe mediatike të kësaj situatë, ka ndikim të dukshëm një lloj filozofie e gjykimit përmes një

Iloj “pandeterminizmi” urban, social dhe demografik, që herë përdoret si mjet dhe pastaj si argument, me të cilin analizohen problematikat urbane, civile, kulturore të këtyre zonave të popullsisë që jeton në to. Është qëndrim i turpshëm, gati reminishencë e “racizmit pa racë”, shikimi “en block” i problematikave të jetës periferike të qyteteve tona, çështjet e cilësisë së jetës të popullsisë që jeton në to.

Për pasojë, sot, në qytetet tona, që janë bërë me “dy pamje”, ka probleme të thella dhe tërësisht të dukshme të cenimit të cilësisë së jetës urbane, kulturës qytetare, e shoqëruar me konflikte pronësore, mungesë aksesit për të plotësuar normalisht nevojat e një jete të qytetëruar. Nëse do të jemi të sinqertë me veten deri në fund, duhet të pranojmë që jo për faj të të ardhurve në qytet, por për mungesë të përgatitjes së kushteve ligjore e urbane të akomodimit të tyre në strukturat e jetës urbane, qytetet kanë marrë pamje dhe strukturë funksionale, në shumë raste, të deformuar.

Nuk e di sa është i vërtetë konstatimi im, por më duket se në këto tri dekada të demokracisë dhe lëvizjes së lirë, qytetet tona kanë humbur diçka të rëndësishme nga autenticiteti dhe funksionaliteti i tyre. Ato janë bërë gati si “qytete me dy pamje”. Nga njëra anë, janë zonat urbane me kushte të superurbanizuara, në të cilat kushtet e jetës janë normale dhe, nga ana tjetër, janë periferitë urbane të qyteteve ku jetojnë shumica e të “ardhurve”, të cilët, në jo pak raste, jetojnë në kushte ku nuk u plotësohen kërkesat bazë të cilësisë urbane, pra në kushte jo fort normale.

Nuk kemi pse t’i mbulojmë të vërtetat tona me “gjethe fiku”. Ato duhet t’i pranojmë ashtu sikurse janë në të vërtetë. Qytetet tona janë bërë vërtet me “dy pamje”. Nga njëra anë është zona urbane dhe pas saj është një hapësirë rrethuese periurbane, ku jetojnë, besoj, pjesa më e madhe e popullsisë që kanë ardhur nga zonat rurale e periferike në qytetet metropolitane. Edhe pse janë bërë përpjekje nga qeveritë dhe pushtetet lokale të këtyre qyteteve, situata ka probleme me natyrë sociale, arsimore, shëndetësore etj.

Personalisht, nuk gjykoj se kjo situatë, e qyteteve me “dy pamje”, është shqetësimi urban kryesor. Por, nga ana tjetër, ka probleme të tjera që janë më thelbësore, ekzistenciale dhe që duhen vlerësuar me seriozitet, sepse në qytetet tona vihet re një “vendosje e përqendruar në grup” e njerëzve të ardhur, të cilët qëndrojnë bashkë ngaqë duan të mbajnë shpesh, me përparësi, ruajtjen e kohezionit natyror, fisnor e kulturor. Për pasojë, nuk është ndonjë vlerë e shtuar ose që duhet mbivlerësuar, fakti që “shpërnguljet” janë bërë kompakte a krahinore, me njerëz që kanë ardhur nga zonat rurale të përbashkëta në periferinë e njëjtë të qyteteve. Pse ndodh kjo?

A ka dëme kjo psikologji krahinariste dhe ky mentalitet kulturor? Patjetër që këto “ngulime” nëpër periferitë e qyteteve tona, shpesh bëhen pengesë për integrimin urban, absorbimin e tyre në mënyrë organike në kanalet e jetës urbane qytetare dhe të qytetëruar. Të ardhurit e kanë më të udhës, që për këto arsye duan të ndërtojnë “solidaritete krahinariste të mbyllura”. Nganjëherë, si mënyrë për të siguruar mbështetje për njëritjetrin dhe për të zbutur nevojat ekzistencialisht imediate. Por, nga ana tjetër, këto lloje “solidaritetesh”, në dukje arkaike, konsiderohen prej tyre si “mjet mbrojtës” përballë qëndrimeve difidente të pjesës tjetër të banorëve autoktonë.

Gjithë problemi është si mund të gjendet mënyra e duhur për ta bërë qytetin me “një pamje”, çfarë duhet bërë për të siguruar një raport të drejtë midis “dallimit” të tyre dhe nevojës së integritit social në jetën e qytetit të përbashkët. Doemos, kjo nuk do të thotë që të mos respektohen ata, traditat e tyre, kultura dhe identiteti. Por, nga ana tjetër, “qyteti me një pamje” bëhet duke u kërkuar të “ardhurve” që edhe ata duhet të mohojnë diçka nga e kaluara e tyre, në emër edhe të dëshirës së integritit urban. Në këto kushte duhet shumë punë nga shteti, nga shoqëria dhe nga vetë të ardhurit, në mënyrë që jeta e tyre në qytet të progresojë dhe të integrohen në hullinë e jetës urbane të qytetit me “një pamje”. Sepse ndryshe, duke mbetur në “anën e dytë” të qytetit, ata do të mbeten larg standardeve të jetës qytetare, për pasojë mund edhe

të degradojnë treguesit e jetës që kanë të bëjnë me arsimin, kulturën, martesën etj.

Nuk është normale dhe as e arsyeshme që vlerësimi për standardet dhe cilësinë e jetës së të ardhurve në qytet, të vendosur në zonat periferike të tij, të shihen me përbuzje apo në tërësi si “grup i ardhur”. Ka shumë prej tyre që janë integruar në jetën urbane, kanë gjetur orientimin e duhur të jetës dhe i kanë përcaktuar qartë kornizat e projektit familjar.

Fjala është për atë pjesë që ende ka nivel të ulët të cilësisë së jetës urbane, që jeton në varfëri e ku të munden, ose që e kanë gjetur “stabilitetin” e jetës së tyre jashtë kushteve të përbashkëta të planifikimit urban të qytetit. Kjo pjesë e popullsisë qytetëse, që jeton në strukturat e pamjes tjetër të qytetit, ka probleme të dukshme me strehimin dhe punësimin, me arsimimin e fëmijëve, me kushtet higjieno-urbane etj.

Kjo është arsyeja pse ata, me raste, ndihen të veçuar nga qyteti, nga strukturat e përbashkëta të jetës urbane, të margjinalizuar nga hallkat bazale të jetës qytetare, të diferencuar disi në raport me botën e punës. A mund të themi se ekzistenca e “qytetit me dy pamje”, me nivele të diferencuara të fibrës urbane midis zonave qendrore dhe periferike, është shkak për ekzistencën e një lloji “pabarazie sociale” midis qytetarëve që jetojnë respektivisht në to? Ligjërisht, kjo padrejtësi nuk ekziston. Qyteti me “dy pamje” nuk është arsye e “mjaftueshme” që të kemi edhe qytetarë me dy lloje statusesh të ndryshme. Banorët e qendrës dhe të periferisë urbane, janë njerëz me status ligjërisht të barabartë, por në të njëjtën kohë, për të qenë të sigurtë, nuk mund të mohojmë faktin që, tashmë, jo ligjërisht, por realisht, ka filluar të duket “vija ndarëse” midis “de jures” dhe “de factos”, midis ligjore dhe empirikes.

Fjala vjen, nëse vërejmë raportet e popullsisë periferike me botën e punës, nuk është vështirë, statistikisht, që të dallosh një lloj diferencimi në status, ngaqë një pjesë e mirë e popullsisë në këto zona ose është e papunësuar, ose është zotëruese kryesisht e “zanateve të ulëta”, si: punëtor, pastruese, shitëse, banakiere etj. Nuk është normale që të ekzistojë ky diferencim në këto nivele, që favorizon popullsinë që jeton

në zonat qendrore në raport me ato periferike. Mund të gjejmë argumente dhe të sajojmë shkaqe sa të duam për aftësitë e tyre, nivelin e arsimit, pengesat e traditës dhe të kulturës. Por të gjitha janë të pamjaftueshme për të fshehur një lloj të vërtete që shfaqet, si “epërsi e padrejtë”, që funksionon “de facto”.

Besoj se përveç politikave të tjera qeveritare, lokale, ridimensionimeve të natyrave komunitare të organizimit të jetës së tyre, është e udhës rindërtimi dhe vënia në funksion e një lloj “inxhinierie sociale”, që duhet të bëhet mjet jo për veçimin, por, përkundrazi, për integrimin e natyrshëm të popullsisë periferike, në mënyrë që edhe ajo të ketë kushtet dhe t’i mundësohet e drejta e përfshirjes si e barabartë në mjediset e integruara të “qytetit me një pamje”.

Qyteti, lëvizshmëria dhe “heterofobia urbane”

Një nga treguesit e fazës së zhvillimeve postmoderne të shoqërisë shqiptare (përveç shumë drejtimeve dhe aspekteve të tjera) është rritja e shpejtë, galopante dhe e menjëhershme e popullsisë dhe e dimensionit urban të qyteteve tona kryesore. Dekadat e fundit kanë qenë dëshmitare të një “urbanizimi dramatik”. Për pasojë, fizionomia e qyteteve dhe tipologjia e jetës urbane në Shqipëri, në këto dy dekada e gjysmë, ka pësuar transformime të thella strukturore, ndryshime rrënjësore, të cilat nuk mund të gjykohen as me paragjykime radikale heterofobike, ca më pak me mungesë të ndjenjës së përgjegjësisë qytetare në emër të së drejtës liberale të lëvizjes, por as me mentalitete egoiste urbane.

Doemos, këtë proces të ristrukturimit demografik, social, kulturor dhe ekonomik të qyteteve tona, nuk mund ta gjykojmë në mënyrë të njëanshme ose duke u nisur vetëm nga presionet sociale, ankesat individuale dhe cinizmi artificial i papranuar i “ekskluzivitetit urban” të banorëve autoktonë të qyteteve pritëse, sidomos me shëmtinë evidente të megalomanisë pseudo-elitare të tyre. Ndryshimet në strukturat urbane

dhe dimensionet e tjera të qyteteve tona kanë ndodhur dhe vazhdojnë ende të jenë të pandalshme.

Në këtë proces, me ndikim të fortë social-ekonomik, luan rol të madh fakti që ende në mënyrë masive dhe pa u ndalur popullsia rurale vazhdon “dezertimin” nga vendbanimet autoktone, duke u dyndur shpeshherë pa logjikë social-ekonomike në qytetet e parapëlqyera subjektivisht. Bashkë me popullsinë rurale, në këtë proces kaotik, ka ndikime të zgjeruara sasiore demografike edhe largimi masiv i banorëve të “qyteteve të ndryshkut” (qytetet e krijuara artificialisht në kohën e komunizmit, të paralizuar ekonomikisht për shkak të mbylljes dhe daljes nga tregu i uzinave e fabrikave të vjetra).

Kjo është situatë e postranzicionit dhe e qarkullimit urban të qytetarëve shqiptarë në këto 30 vjet të ndryshimeve demokratike. Problemi është se në këtë proces të dyndjes urbane, dimensionet e tij janë të paabsorbueshme, sepse “këmisha urbane” e qyteteve nuk ka kapacitete për të përballuar këtë valë gjigante, ku janë bashkuar të ardhurit nga qytetet periferike me banorë të fshatrave, nga të cilët një pjesë, me të drejtë, duhen konsideruar se kanë qenë dhe janë mbajtur me forcë në “vendndodhje të gabuar”. Kjo tendencë e urbanizimit të sforcuar, është kosto e së kaluarës, të cilën jemi të detyruar ta “paguajmë” të gjithë individualisht, sidomos duke dëmtuar rëndë, në shumë raste, cilësinë e jetës urbane, standardet e kërkuara të qytetërimit tonë.

Në gjykimin e njerëzve që banojnë sot nëpër qytetet kryesore të Shqipërisë dhe duke vlerësuar me objektivitet situatat urbane që zhvillohen rreth tyre, të cilat kanë impakt në mënyrën e administrimit të tipologjisë së jetës urbane, është krijuar një ndjenjë e përgjithshme, se tashmë jemi në situatën kur për shkak të kaosit të krijuar prej lëvizjes së lirë, të gjitha qytetet tona janë kapluar nga anarkia urbane, nga kaosi demografik, nga dobësimi i standardeve të jetës sociale e të sigurisë morale. Kjo situatë, e vlerësuar me parametrat sociologjikë të qytetërimit, është e tillë, që jo pak njerëz kanë filluar të flasin në mënyrë

pezhorative, flitet jo për qytete me fizionomi të rregullt urbane, por për krijimin e të ashtuquajturave “xhungla urbane”.

Në vend që të shajmë, të bëjmë ekzibicione mohuese, është më mirë të përballemi me realitetet, të kuptojmë dhe të përballojmë ambiguitetin e këtij realiteti socio-demografik dhe të gjejmë jo me fjalë, por me aksione e veprime të përsheptuara urbane kuptimin e duhur të kësaj domethënie të pashmangshme të jetës së sotme sociale. Kjo sepse “revolucionin urban”, që ka ndodhur në dy dekada e gjysmë, i ka dhënë fund ideve romantike të qyteteve të mbyllura me “mur administrativ”, ka përmbysur përfundimisht imazhin tradicional të konceptimit të qyteteve sipas modelit të ngurtë të së kaluarës.

Kjo tipologji qyteti dhe jete të mbyllur urbane ka marrë fund, që nga dita kur shqiptarët fituan lirinë dhe bashkë me të edhe të drejtën e lëvizjes. Kështu që dekonstruksioni i fizionomisë urbane, bashkë me të i relacioneve të marrëdhënies sociale dhe lidhjeve të tjera midis “autoktonëve” dhe të “ardhurve”, është një realitet që duhet njohur, pranuar dhe përshtatur me të. Jeta e sotme qytetare në Shqipëri nuk ka nevojë për ringjalljen e ndonjë “ideologjie urbane heterofobike”, as për evidentimin artificial të origjinave krahinore dhe identiteteve të tjera njerëzore. Aq më pak për paragjykime segregative të llojeve të ndryshme, ndarje fizike ose, akoma më keq, për krijimin e “divergjencave” më të thella metafizike, që mund të ndikojnë negativisht në marrëdhëniet midis njerëzve në qytetin e ri të përbashkët.

Realitetet e jetës urbane janë të tilla që na detyrojnë të gjithëve, autoktonë e të ardhur, të kuptojmë kohën, të bëjmë dialogun e duhur human për të gjetur modalitetet e reja që duhen për t’u përshtatur me ndryshimet e jetës së përbashkët urbane. Heterofobia e kotë, pa logjikë demokratike e ndjenjë humane, i ka bërë bosh, pa substancë, besnikëritë e vjetra demografike elitare të disa njerëzve, që vazhdojnë të mbeten rob të dogmatizmit të vjetër urban, “besnik” të disa ideve arkaike aristokratike, që kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë “mbetje sociale”,

që ushqehen prej ideve urbane të dërrmuara plotësisht nga presionet demokratike të kohës postmoderne në Shqipëri.

Kjo do të thotë se, në situatat e sotme urbane, nga qytetarët dhe strukturat e pushtetit administrativ vendor duhen njohur të vërtetat që vijnë nga realitetet e reja të ridimensionuara demografikisht, të rikonfigurimit të qyteteve dhe ridimensionimeve të hapësirave të jetës qytetare.

Sociologët urbanë duhet të arsyetojnë bashkë me këto zhvillime dhe të përcaktojnë më mirë konturet sociologjike të këtyre transformimeve demografike të jetës urbane, sepse ndryshimet e jetës materiale dhe të fizionomisë së qyteteve tona janë procese që mund dhe duhet të ndikojnë jo vetëm në transformimet gjeografike e demografike, por më shumë ato ndikojnë vrullshëm në transformimin e esencës qytetare, krijimin e ndërjegjes së ndryshuar të njerëzve tanë për jetën urbane, nevojën ekzistenciale të sigurimit të bashkekzistencës qytetare të njerëzve, qoftë autoktonë ose të ardhur.

Pa dyshim, këto ndryshime rrënjësore, të ndodhura në një kohë të shkurtër dhe përmes një procesi pothuaj spontan, të paorientuar e kaotik, do të krijonte vështirësitë e absorbimit të natyrshëm të të ardhurve në jetën urbane dhe, domosdo, kjo do të shoqërohej me shfaqjen e fenomeneve të reja urbane e sociale. Natyrisht edhe nga vështirësia dhe kontradiktat e shfaqura, si pengesë për t'i absorbuar përmes skemave të njohura të jetës së qytetëruar dhe normave të vetëdijes urbane të pjesës së qytetarëve të ardhur. Kjo është, natyrisht, e lidhur me faktin se në shoqërinë tonë duhet ende shumë punë dhe përpjekje kulturore e sociale, me qëllim që të respektohen vlerat e njohura të qytetërimit urban nga të gjithë, autoktonë e të ardhur.

Kjo do të thotë që, duke sulmuar mentalitetin e heterofobisë, në të njëjtën kohë nuk ka pse të mos njohim të vërtetat që na shqetësojnë, qoftë si qytetar apo problemet e shfaqura në jetën urbane për shkak të kaosit të lëvizjeve demografike ose për shkak të diferencave të tjera historike, kulturore, materiale, të traditave dhe zakoneve të njerëzve

të grumbulluar në qytete. Por, nga ana tjetër, nuk ka pse të bëjmë të habiturin përballë realiteteve që përjetojmë, ose të bëjmë “dialog prej struci” duke ulëritur për “deformimin e standardeve” të jetës urbane, kur fare mirë të gjithë e dimë e jemi të vetëdijshëm për ndikimin që do të kishin në jetën e rimodeluar urbane “diferencat” e nivelit të diversifikuar të qytetërimit tonë në nivelin urban dhe rural.

Mjafton të kujtojmë se sa e madhe ka qenë diferenca e jetës ose, më saktë, diferenca sasiore e cilësore e fshatit nga qyteti në Shqipëri, për të kuptuar “pse”-në dhe për të shpjeguar arsyet e këtyre realiteteve shqetësuese që ka jeta e sotme urbane. Ne duhet ta kuptojmë mirë situatën dhe të përpiqemi të rregullojmë shqetësimet dhe anomalitë që kanë ardhur nga “efekti shpërthyes” demografik e urban i jetës në Shqipëri, të cilin e kemi përditë të pranishëm. Para syve tanë ai shfaqet bujshëm në anomalitë urbane, me ndërtimet pa leje, me sistemin e shkollave dhe të vështirësitë e saj, në përballimin e nevojave sociale, varfërisë artificiale të krijuar nga braktisja e fshatit dhe në kushtet materiale të jetës për hatër të qytetit, utopisë dhe iluzioneve të jetës urbane etj.

Situatat reale të jetës urbane në vendin tonë nuk mund të gjykohen as me optika të deformatuara, as me paragjykime urbanocentriste. Ato kërkojnë zgjidhje si mjet për të rregulluar homogjenizimin urban të qyteteve, që janë gjithnjë e më shumë në zmadhim sasior e cilësor tejet intensiv dhe të pandalshëm. Në vend të gjykimeve të gabuara apo të paragjykimeve heterofobike urbane, që janë koncepte të vjetra e boshe, na duhen ide urbane dhe qëllime urbanizuese të thjeshta e të drejtpërdrejta. Të gjitha këto mund të na ndihmojnë për të arritur një situatë të mundshme të dialogut qytetar dhe një konsensus ndërqytetëruar, për të bërë kompromisin e duhur si kusht për t’i unifikuar këto realitete sociale dhe bashkëjetesa të reja urbane.

Është e vërtetë që koncepti tradicional për qytetin dhe për jetën e qytetëruar ka pësuar ndryshime të thella ekzistenciale. Me sa duket, në kohën postmoderne, si kudo në botë, edhe në vendin tonë nuk ka

më fuqi ekzistenciale koncepti elitar e aristokratik për qytetin, si vend i bashkëjetesës midis grupeve të “arsyeshme” dhe të “qytetëruara”. Vendin e dikurshëm të qyteteve të mbyllura tradicionale (në kuptimin sociologjik) tani po e zënë qytetet e reja, të transformuara demografikisht, kulturalisht (heterogjenetike). Këto janë realitete universale të natyrës së qytetit postmodern që shfaqen kudo në botë.

Në sociologjinë urbane aktuale theksohet fakti që qytetet dhe fshatrat janë bërë “plastike” për nga natyra. Në këto kushte, arsyetojnë sociologët, “ne i formojmë ato në përfytyrimet tona”. Ndërkaq ato na trajtojnë me anë të rezistencës që na ofrojnë kur ne rrekemi t’u imponojmë “formën tonë personale”.

Ka ardhur koha që të bëhet akoma më shumë për të ndryshuar kushtet materiale që diktojnë mënyrën dhe rregullat e jetës urbane, me qëllimin për të ndalur mbipopullimin kaotik, reduktimin e mjediseve të përbashkëta komunitare e publike, forcimin e rendit dhe të bashkëjetesës komunitare. Nuk është i shëndetshëm qyteti nëse është nën ndikimin e faktorëve që e bëjnë jetën të vështirë, të padurueshme, kur grabitjet shtohen dhe shërbimet publike pakësohen, dhuna e krimi rriten dhe njerëzit, për t’u mbrojtur nga të këqijat e jetës urbane, vetizolohen në subjektivitetin e tyre.

Koha kërkon që politika, shteti, sociologët, urbanistët, arkitektët dhe intelektualët shqiptarë, në përgjithësi, të tregohen të gatshëm që të kontribuojnë realisht dhe konceptualisht për mënyrën si duhen ndërtuar dhe vënë në funksion qytetet tona të të sotmes dhe të të ardhmes. Kjo kërkon që të gjithë si qytetarë të këtij vendi ta rimendojmë me përgjegjësi sociale konceptin që kemi për *Qytetin ku jetojmë të gjithë së bashku!*

Ontologjia e konfliktit të qytetarit me qytetin e tij

Sa më të mëdha bëhen qytetet tona, aq më shumë probleme sociale gjelojnë brenda tyre. Shoqëria shqiptare, momentalisht po përballet me

dukurinë universale të zgjerimit të zonave urbane metropolitane, që janë rajone me popullim të gjerë dhe që kanë nevoja urgjente për urbanizim të plotë, për zgjerimin e “këmishës urbane”. Në harkun kohor, brenda dy dekadave, në të gjitha qytetet tona është duke u zhvilluar e njëjta dukuri urbane, e shoqëruar me fenomene të ngjashme sociale. Kudo po shtrihen, në gjerësi, hapësirat urbane, po zgjerohen konturet sociale dhe territoriale të qyteteve, të cilat, nga pikëpamja demografike, vazhdojnë të jenë nën ndikimin e fortë të “ekspansionit demografik”.

Në këtë kontekst, sot, në jetën horizontale dhe vertikale të qyteteve kanë lindur probleme të reja, që kanë rëndësi thelbësore dhe që në mënyrë të natyrshme janë pasojë e ndërtimit ndryshe të raporteve tradicionale e klasike të njeriut me qytetin e tij. Fenomene ekonomike, kulturore, sociale e demografike, që nuk mund të shihen dhe të vlerësohen sociologjikisht, duke u bazuar në paradigmat e urbanizimit të ngushtë të modelit të kufizuar të strukturës së qyteteve dhe përmasave të qytetërimit të kaluar. Ky është problemi më kompleks me natyrë ekonomike, kulturore, sociologjike dhe ekzistenciale për riformatimin me standarde të reja të qytetërimit tonë, që do të thotë se ka ardhur koha për t’i trajtuar ndryshe problemet sociale, të cilat burojnë nga raportet e reja të “qytetit të madh” me “qytetarin e vogël”.

Ato janë probleme të mprehta të ditës, por edhe të perspektivës urbane, që meritojnë të analizohen dhe të trajtohen sociologjikisht. Shqipëria është në një proces masiv transformimesh të strukturës dhe infrastrukturës politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Ne jemi në qendër të “ciklonit urban”, dhe doemos edhe të përfshirë nga vala eruptive e ridimensionimit territorial, e koncentrimit demografik urban. Kjo është fare e evidente, sidomos në zonat metropolitane. Këto zhvillime kanë krijuar një raport të ri, që në pamje të parë dhe të vlerësuar në formë sociologjike simpliste, të duket sikur është ekuivalent me qytetërimin perëndimor, që i ka të natyrshme kontradiktat midis zgjerimit pa limit të hapësirave social-ekonomike të “qytetit të madh” dhe shtimit të problemeve të integritetit të “qytetarit të vogël”.

Nuk është koha për të bërë vetëm vlerësime numerike e statistikore, për të vërtetuar një proces i cili ka përmasa totale në shoqërinë shqiptare. Sigurisht edhe ato duhen, por para së gjithash duhen parë në thelbin e tyre problemet sociale që burojnë nga ky raport i brishtë, që shfaqet në marrëdhëniet e qytetit dhe qytetarit. Ndaj duhet t'i drejtohem me seriozitet përballimit të dilemave të këtij raporti të ri urban, demografik dhe ekzistencial me të cilin jemi duke u përballur fort, sepse marrëdhëniet e qytetarit me qytetin e vet janë shpesh kaotike, voluntariste, tejet liberale, shpesh duke i lënë gjërat në rrjedhën e tyre spontane.

Çështjet sociale, problemet e ndërthurura të mjedisit natyror të metropolit (qytetit të madh) dhe problemet sociale individuale të qytetarit, duhen kuptuar dhe interpretuar drejt. Sinkretizmi i këtyre dy elementeve të qytetërimit duhet parë jo vetëm në rrafshin e madh të sociologjisë doktrinariste, që analizon shkaqet dhe dukuritë e mëdha të këtyre dy hallkave (qytetit dhe qytetarit), por edhe në këndshikimin inkrementalist të jetës së përditshme, duke shfrytëzuar në këtë rast mundësitë e veçanta që ka mikrosociologjia.

Në analizat që bëhen rreth këtij “binomi ekzistencial”, ka më shumë interpretime të përgjithshme për raportet e *Qytetit të Madh* me qytetarin si genie individuale. Në fakt zhvillimi, ndryshimi thelbësor i rrjedhave konkrete të jetës sociale në Shqipëri nuk ka nevojë vetëm për studime strategjike e filozofime të përgjithshme sociologjike, ose për analiza të vlerësimit postfaktum të ndryshimeve që po ndodhin në raportin esencial të jetës moderne midis qytetit dhe qytetarit.

Kjo detyrë është objekt parësor për zhvillimin e sociologjisë urbane, që duhet të analizojë në mënyrë tërësore procesin e sinkretizuar të zhvillimit të qytetërimit tonë. Por shoqëria shqiptare ka disa probleme më të vogla sociale, që janë të veçanta, me natyrë parciale e lokale, që prekin masa më të kufizuara njerëzish. Në Shqipëri ende flitet pak ose aspak për nevojën që ka shoqëria për të zhvilluar dhe zgjeruar objektin e studimit të “mikrosociologjisë urbane”, e cila ka mundësi të gjera të

intervenojë në mënyrë kapilare procese sociale të kufizuara, të studiojë dukuritë që shfaqen në ndërveprimet individuale dhe problemet sociale që shfaqen të lokalizuara në marrëdhëniet e reja midis qytetit dhe qytetarit.

Në historinë e sociologjisë, në fushën e studimeve të ndryshimit të kurbës dhe transformimit të diagramit të ndryshimeve urbane, qoftë të atyre që vijnë nga zhvillimi i “këmishës urbane” ose nga intensiteti i ndryshimeve demografike, ka përvoja të shkëlqyera teorike, që mund të shërbejnë si ndihmesë e madhe për studimet konkrete sociologjike, që duhet të bëjmë në përpjekjen për parandalimin e kontradiktave të thella, zgjidhjen e natyrshme të problemeve që krijohen vazhdimisht në lidhjen dhe korelacionin e marrëdhënieve midis qytetit dhe qytetarit. Shkolla e famshme sociologjike e Çikagos, në gjysmën e parë të shekullit të 20-të, ka shënuar sukses të njohur shkencor ndërkombëtar, sepse sociologët e saj e gjetën kohën dhe u angazhuan seriozisht me proceset dhe me dukuritë sociale që ndodhën gjatë zgjerimit galopant të këtij qyteti metropolitan. Ne duhet të merremi seriozisht me analizën e karakteristikave, me tiparet tipike të aftësive përshtatëse dhe me mënyrat e komportimit social të qytetarit shqiptar, i cili përpiqet të gjejë “busullën urbane” që të orientohej, të jetojë, të përshtatet në dimensionet e natyrshme të jetës kaotike, në situatën brovniane të mjedisve pluraliste të qytetit metropolitan. Ky integrim, siç po e tregojnë faktet, duket se nuk është kaq i lehtë dhe “paqësor”, sepse tani po përballemi gjithnjë e më shumë me njerëz, të cilët jeta ndryshe e qytetit të madh po i lodh.

Qytetet janë bërë mjedis sociale në të cilat njeriu nuk gjen prehje apo një mjedis që të bjerë në qetësi. Përkundrazi, qytetet e kanë mbështjellë njeriun si qenie dhe individ, me peshën sociale të mbresave të forta, përballjen me konkurrencën për sukses individual, me rreziqet e mëdha të dështimit të papritur, me pasiguritë ontologjike dhe rrëshqitjet e mëdha me natyrë subjektive. Qyteti nuk është gjithnjë dhe për të gjithë “mjedis miqësor” sipas konceptit klasik, tradicionalist të qytetit paramodern.

Përkundrazi, ai ka më shumë shanse për suksesin e qytetarit, po aq sa i rezervon edhe të papritura jo të këndshme në çdo çast.

Këto janë arsytet pse një pjesë e njerëzve tanë janë të tronditur ekzistencialisht me mënyrat e paqarta, të pasigurta, të integritit të tyre në qytetet e sotme të mëdha metropolitane shqiptare. Madje, nuk janë të paktë qytetarët, që përballë këtij realiteti, kanë humbur ndjeshmërinë e duhur të sfidës së adoptimit social dhe aftësitë përshtatëse individuale me “grackat” e jetës urbane, mjedise sociale të qytetit. Ndaj, shpesh në jetën kaotike të qyteteve të mëdha, ata ndihen të vetmuar, të braktisur, pa përkrahjen e duhur për të qenë socialisht të integruar në hullinë e tij.

Në këto kushte, mbrojta e qytetarit nga rreziqet dhe nga të papriturat e qytetit dhe të jetës qytetare është një ekuacion kompleks, me shumë faktorë dhe përgjegjësi sociale dhe individuale. Por një gjë është e sigurt. Mbrojtja e qytetarit nga ankthi i jetës urbane, nga vështirësitë dhe pasiguritë e qytetit të madh, mund të realizohen duke e ndihmuar njeriun të kuptojë që sa të domosdoshme janë në kohën e dobësimit të kohezionit qytetar, pra solidaritetit social dhe humanizmit njerëzor, ruajtja në nivele të qëndrueshme ekzistenciale e lidhjeve të forta sociale të qytetarëve me familjen biologjike dhe me komunitetin rrethues.

Qytetarët, të ardhur në mënyra të ndryshme, me motive diverse në qytetet e mëdha, qoftë nga fshati dhe nga mjedise rural, ose nga qytete të vogla provinciale, tani ndihen të “tjetërsuar” demografikisht, sepse nuk ndodhen në “habitatit tradicional” të tyre. Përkundrazi, në “honet” e qytetit të madh ndihen keq, u duket se ndodhen në një “mjedis të huaj” ku nuk mund të sigurojnë “mbrojtje”, ku përjetojnë ndjenjat e marginalizimit përballë sfidave të qytetit të madh.

Natyrshtëm, sociologjikisht është e pritshme, që një pjesë e madhe e tyre të jenë qytetarë të frikësuar, njerëz me ndijim skeptik për gjithçka, ngaqë në jetën e qyteteve të mëdha nuk ka shumë lidhje, as funksionim sa duhet të lidhjeve të ndërmjetme biologjike, fisnore apo të gjakut, lidhje që ende janë të pranishme në mjediset sociale të jetës rurale ose edhe provinciale. Në qytetin e madh jeta ka një “formulë” tjetër, sepse

këtu çdo gjë konvertohet vetëm në lidhje interesi dhe paraje. Kjo është arsyeja që kalimi nga habitati rural në mjediset e gjera të jetës urbane ka tronditur njerëzit e ardhur, të cilët e kanë kuptuar të vërtetën e madhe të këtij lloj qytetërimi, “lojës unike” të qytetit të madh, në të cilin nuk ka gjëra të sigurta, të garantuara për qytetarin individualisht.

Kjo ndodh sepse e gjithë jeta urbane është sasiore dhe e mbështetur në marrëdhëniet e thjeshtëzuara mall-pará, ku ka gjithnjë e më pak hapësirë për marrëdhënie të vërteta sociale. Kjo situatë është pasojë e së vërtetës, se gjithnjë e më shumë po ngushtohet hapësira cilësore e vlerave njerëzore, po zbehen bazat tradicionale të humanizmit dhe solidaritetit. Në kushtet e qytetit të madh këto mekanizma të lidhjes së njeriut me shoqërinë, me jetën, me mjedisin social dhe habitatin organik nuk funksionojnë.

Ato janë ekzistencialisht jashtë realitetit të jetës metropolitane, jashtë kufijve të “botës monetariste” të qytetit të madh. Kjo do të thotë se në mënyrë të pakthyeshme, do të ecim në rrugën e përcaktuar, sipas së cilës, sa më të mëdha do bëhen qytetet tona, aq më e vështirë bëhet ekzistenca e lidhjeve sociale të qëndrueshme, marrëdhëniet humane dhe lidhjet qytetare midis njerëzve.

Për këtë arsye, sociologu i shquar Georg Simmel, në veprën e tij “Metropolet dhe mendësitë”, duke analizuar dukurinë e ballafaqimit të “qytetit të madh”, me “njeriun e vogël” shkruan se: “... është krejt e pamundur të kesh marrëdhënie afektive të spikatura ndaj shumësisë së genieve me të cilat takohesh në një qytet të madh”.

Vetëm sociologët demagogë, konservatorë dhe utopistë nuk mund të mos e dallojnë se marrëdhëniet e qytetarit me qytetin po bëhen më të ftohta, më impersonale, të atomizuara, gjithnjë më multidimensionale, heterogjene dhe heterotipike. Kjo është baza ontologjike e shoqërisë moderne, e cila edhe te ne, po ndikon vrullshëm në zgjerimin e “largësisë sociale” në marrëdhëniet qytetare të njerëzve me njëri-tjetrin.

Kjo do të thotë që në vend të iluzioneve dhe gënjeshtreve sociale, të themi të vërtetat e jetës së vërtetë. Duhet t’i përgatisim njerëzit tanë me

idenë e pakthyeshme, sipas së cilës, sa më moderne do të bëhet shoqëria, aq më shumë marrëdhëniet midis njerëzve në qytetet e mëdha marrin karakter të ftohtë impersonal. Qyteti nuk është në dorën e sociologjisë, por sociologjikisht duhet të tregojmë problematikën sociale, e cila është bërë faktori themelor që i jep orientim tejet individualist jetës së qytetarëve. Ky është rregull i përgjithshëm i postmodernitetit.

Metropoli është faktori i madh që i shkatërron në mënyrë të pariparueshme, qoftë lidhjet e vjetra sociale tradicionale të botës rurale apo rregullat solidariste të qytetit provincial, në të cilin funksionojnë ende zakonet, traditat, lidhjet humane dhe kohezioni i vjetër social. Të gjitha paragjykimet e jetës provinciale në qytetin e madh, shpartallohen “pa kushte” nga presioni gjithëpërfshirës i qytetërimit, i luftës së njerëzve për mbijetesë, garë, sukses, pse jo edhe për ekzistencë. Këto janë raportet e reja, të krijuara në shoqërinë tonë, të cilat gati në mënyrë automatike, pa ndërmjetësimin e shoqërisë, vendosen në “kodin” e lidhjeve dhe marrëdhënieve midis qytetit të madh metropolitan dhe qytetarit të vogël urban.

Në këto kushte, s’ka asnjë iluzion për mundësitë e imagjinuara të suksesit në jetën urbane. Ai ekziston si mundësi për ata njerëz që e arrijnë atë si qytetarë. Por, nga ana tjetër, nuk duhet harruar se nuk ka sukses në metropol, në “xhunglën metropolitane”, në bashkësinë e gjerë të njerëzve të njohur e të panjohur, nëse nuk gjen mundësitë e afirmimit të origjinalitetit dhe shanseve individuale.

Qyteti i madh hap vërtet më shumë mundësi për individin, sepse, siç thonë sociologët e qytetërimit postmodern, ai është “erashkë e gjerë mundësish”. Por jo të gjithë kanë aftësi t’i shfrytëzojnë këto mundësi. Qyteti i madh është bërë si një “makinë me ingranazhe” të mëdha, përballë të cilit qytetari duket si “qenie e vogël”, që duhet të përfshihet në kahun e lëvizjes së ingranazheve të tij.

Zgjerimi i qyteteve dhe bashkëjetesa urbane

Tani që qytetet tona janë zgjeruar në mënyrë të gjithanshme, ekstensive dhe intensive, deri në kufijtë e metropoleve të vërteta, mund të themi se ndodhemi në fazën e problemeve të shumta, të cilat, nga pikëpamja hapësinore, fizike dhe urbanistike, janë bërë tejet komplekse. Qytetërimi ynë po përballlet me shumë probleme ekonomike, sociale dhe kulturore. Qytetet tona janë “ndërlikur” nga pikëpamja e zgjerimit të kufijve demografikë dhe territorialë.

Bashkë me to, është duke ndodhur zgjerimi i lidhjeve dhe shtimi i shpejtë i problemeve të organizimit dhe komunikimit social të qytetarëve. Njerëzit kanë shfrytëzuar, ashtu si kanë mundur, të drejtën e lirisë për të lëvizur me ritme të larta drejt qyteteve. Nga ana tjetër, krahas të mirave të natyrshme që sjell jeta urbane për shtresat e “qytetarëve të rinj”, qytetarët me vështirësi janë duke u përshtatur me sfidat e natyrshme të adoptimit organik, me kërkesat standarde të universit të jetës së urbanizuar.

Duke parë strukturën, organizimin social dhe funksionimin e qyteteve tona, ato nuk janë më struktura urbane unike të ndërtuara në mënyrë sociale uniforme. Në këto rrethana, qytetet dhe qytetarët, që jetojnë në to, kanë problemet e tyre, që lidhen me periudhën e vështirë të tranzicionit demografik, që në shumë aspekte ka sjellë me vete kaos të dukshëm urban. Procese të cilat, në shoqërinë shqiptare, janë me kosto të lartë. Ato kanë ndikime të thella në cilësinë e jetës urbane, në mundësinë e adoptimit të njerëzve me kërkesat e jetës qytetare. Qytetet tona, nga pikëpamja demografike, ekonomike dhe urbane kanë marrë pamje të re. Përballimi i prurjeve të shumta demografike ka krijuar situata të ngjashme.

Kjo sepse pothuaj të gjitha qytetet tona kanë marrë trajtën e qyteteve të përbëra nga mjedise të ndryshme shoqërore, në të cilat janë të detyruar të bashkëjetojnë autoktonët me të “ardhurit e lirë”. Mënyra koncentrike e ndërtimit të qyteteve është ajo që bie menjëherë në sy. Sepse të gjitha

kanë marrë formën tipike të kompozimit të tyre, me qendra të forta të koncentruara urbane, të lidhura me periferitë që dallohen për sasinë dhe cilësinë e ndryshme të qytetërimit. Kjo është arsyeja e prezencës së shumë paradokseve sociale, që tashmë duhen vlerësuar seriozisht nëse duam të përmirësojmë funksionimin e qyteteve tona Bashkë me të edhe cilësinë e jetës urbane, përmes përsheptimit të krijimit të kushteve për integrimin e popullsisë periferike në rrjedhat e jetës me standarde të përbashkëta qytetare. Nëse do të analizojmë më thellë situatën, do të dallojmë ekzistencën e shumë problemeve sociale, kontradiktave të jetës urbane, që nuk na lejojnë t'i bëjmë ato mjedise të qytetërimit homogjen, pa shtresëzime mekanike dhe ndarje artificiale koncentrike të qyteteve dhe qytetërimit në nivel urban dhe periferik. Kjo ndarje nuk është e thjeshtë, pa pasoja ekonomike, kulturore dhe sociale, që janë pengesa të cilat duhen kapërcyer, si kusht për të rregulluar jetën qytetare dhe cilësinë e komuniteteve të reja urbane.

Nëse analizojmë sociologjikisht situatën reale që zhvillohet në qytetet tona, duket qartë se ndeshim dy pamje kontradiktore. Madje, në shumë aspekte, të papajtueshme midis tyre. Qytetet tona po zhvillohen, po zgjerohen, po modernizohen duke qenë paralajmëruese të zhvillimit social - ekonomik, kulturor duke marrë dimensione të zgjeruara të qyteteve të vërteta. Por ky realitet, që është qendror, nuk duhet të na pengojë për të parë dhe për të vlerësuar në të njëjtën kohë problemet urbane periferike, probleme që janë shqetësuese, sidomos për mënyrën e jetesës, nivelin e cilësisë së jetës për shtresa dhe grupe sociale të caktuara. Këto shtresa dhe grupe sociale të caktuara janë integralisht dhe fizikisht pjesë e qyteteve tona, por ndërkaq nuk janë po aq të integruara në cilësinë e jetës qytetare.

Kjo situatë urbane kërkon zgjidhje të shpejta, si kusht për të rregulluar këto “enklava” me status të përzier ruralo-urban. Ndryshimi i situatës në qytetet që zhvillohen me “dy shpejtësi”, me ritme të larta urbanizuese nëpër qendra dhe më ngadalë në periferitë e tyre, krijon idenë se ndodhemi përballë një problemi socio-demografik dhe

ekonomiko-kulturor që, së pari, duhet pranuar dhe, në të njëjtën kohë, edhe duhet thënë hapur.

Ne nuk mund të rregullojmë jetën urbane për një pjesë të popullsisë qytetare, nëse nuk shohim dhe vlerësojmë si duhet situatën e popullsisë periferike, e cila për shkaqe të ndryshme ka raste që të duken se janë bërë “simbol”, që tregon për mungesën e mundësive për të garantuar kushtet e bashkëjetesës urbane për të gjithë. Qyteti nuk është vetëm mjedis fizik i thjeshtë, ku mekanikisht vendosen njerëzit, për të krijuar komunitete artificiale, që mbeten me mundësi të kufizuara të integritimit urban dhe social.

Ky koncept semplist, ky përfytyrim i zgjerimit artificial, mekanik, linear i qyteteve tona, tashmë po ndikon në dëmtimin e kuotave ekzistenciale dhe të cilësisë së identitetit dhe tipologjisë së jetës urbane. Zgjerimi i sforcuar i qyteteve, në jo pak raste ka dëmtuar jo vetëm identitetin urban, por dhe atë historik. Bashkë me to edhe vlerat estetike, cilësinë e jetës shoqërore. Qytetet nuk bëhen struktura të jetës organike qytetare pa krijimin e kushteve për të siguruar lidhje dhe marrëdhënie shoqërore midis qytetarëve autoktonë dhe të ardhurve. Këto lidhje nuk janë vetëm me natyrë ekonomike, sociale dhe infrastrukturore, por janë shumë më të thella.

Unë besoj se duhet folur më shumë për nevojën e krijimit të lidhjeve të thella antropologjike dhe kulturore të popullsisë së ardhur dhe atyre të gjendur. Ky kohezion social, kulturor, etik dhe antropologjik është kusht për funksionimin e qyteteve, ndërtimin e standardeve të reja të qytetërimit pikërisht tani kur statura e qyteteve dhe statusi i qytetërimit ka ndryshuar rrënjësisht. Ndërtimi i qyteteve me parimin e zgjerimit të lirë, si proces mekanik voluntarist, ka bërë që tani të ndihet mungesa, dobësimi i “indit lidhës” urban të qytetërimit tonë, që është një nga arsyet kryesore që ka sjellë probleme të shumta ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat dëmtojnë qytetet dhe qytetërimin tonë.

Procesi i unifikimit të standardeve është më i lehtë, sepse qytetet tona janë më të vogla, më të manovrueshme si hapësirë dhe popullatë.

Por, mbi të gjitha, ajo që na ndihmon në këtë rast, është e vërteta se popullsitë që vijnë nëpër qytete, janë përgjithësisht etnikisht dhe kulturalisht homogjenë. Kjo e lehtëson procesin e adoptimit, akulturimit të popullsisë së ardhur në zonat metropolitane. Kjo është një tjetër arsye pse procesi i dyanshëm i dyndjes së popullsisë fshatare nëpër qytetet tona, nuk është bërë me konflikte të mëdha. Përkundrazi, është shoqëruar me procese të buta të integritit, të krijimit të zonave të ndërmjetme të tipit të “tamponit urban”, si moment kalimtar i integritit socio-ekonomik dhe kulturor të tyre.

Ne jemi popull që ende e kemi të fortë ndjenjën komunitare, ndjenjën qytetare të bashkëjetesës më të “ardhurit”. Kjo falë traditës së lidhjeve komunitare, kohezionit social të jetës urbane dhe rurale, lidhjeve të forta të gjakut, fisit dhe komunitetit. Qytetet tona mund të kenë probleme urbane, probleme të organizimit social, të nivelit të zhvillimit të jetës ekonomike, kulturore dhe infrastrukturës së dobët, por ato janë duke u zhvilluar si “qytete komunitare”, në të cilat bashkëjetojnë në harmoni, popullsi të ardhura nga të gjitha anët e vendit, pa pasur asnjë frikë për integrimin social, i cili është i vështirë, por nuk është i pamundur.

Nuk mund të mohohet që, ndërkohë jemi në fazën kur raportet e qytetarit me qytetin, nëse nuk orientohen sipas standardeve të qytetërimit urban, mund të bëhen “marrëdhënie kritike”, që do të cenojnë cilësinë dhe standardet e qytetërimit. Në mënyrë që qyteti dhe qytetari të mos jenë të “huaj” për njëri-tjetrin, që të mos kenë konflikte, duhet të përpiqemi të zgjerojmë qytetet, por jo vetëm në kuptimin hapësinor ose si qëllim urban në vetvete. Së pari, duhet të rregullojnë tërësinë e nevojshme të kushteve të domosdoshme, të krijojmë standardet e ekologjisë urbane.

Qyteti dhe “paqëndrueshmëria sociale”

Pa dyshim, tashmë nuk është paragjykim postmodernist, por realitet: qytetet tona po i konsolidojnë me shpejtësi dy dimensionet e tyre. Kjo

do të thotë se transformimet intensive kanë kapur jo vetëm aspektet e ndryshimeve materiale, urbane e arkitekturore, por ato po shfaqen edhe me një ndryshim të dukshëm të raporteve njerëzore individuale dhe marrëdhënieve sociale të njerëzve që banojnë në to. Epoka e frymëzuar nga postmodernizmi, doemos që ka ndikuar edhe në riformatimin e qyteteve, por edhe në jetën tonë sociale. Kjo situatë ka bërë që në mënyrë krejt të përcaktuar në shoqëri, në qytetet tona dhe në tipologjinë e lidhjeve të reja urbane, të evidentohen shumë dukuri të reja.

Një dukuri, e cila bie më shumë në sy, dhe që është disi shqetësuese, lidhet me fillimin e procesit të rrënimit në jetën qytetare të shumë zakoneve, formave tradicionale të organizimeve sociale, mënyrës së formatimit të bashkësive sociale qytetare etj. Format e reja të mënyrës së të jetuarit në qytetet tona, janë të përcaktuara nga shumë faktorë, ide e forca sociale përcaktuese, të cilat kanë bërë që lidhjet sociale dhe marrëdhëniet ndërpersonale midis njerëzve të dobësohen ndjeshëm. Në fakt, kjo që po ndodh në shoqërinë dhe qytetet tona, nuk është ndonjë rast i veçantë. Gjithçka është koherente me përcaktuesit e kohës postmoderne, e cila, sipas sociologëve, në mënyrë të natyrshme ka sjellë përballjen me faktin që jeta personale e qytetarit në qytet, të përjetojë një proces të fortë “çinstitucionalizimi”, si pasojë e shkallës së lartë të organizimit burokratik dhe ndikimit të fortë të “shoqërisë së masave”.

Në kohën tonë, fati i njeriut është i lidhur me tipologjinë e këtij lloj qyteti, i cili ndikon që qytetari të jetojë në mjedise që shpesh janë si “kazemat e njëtrajtshme”, të ushqyera me njohuri pasive të mjeteve masive të komunikimit dhe që rrethohet me objekte të shëmtuara të prodhimit serik”¹.

Kjo do të thotë se jeta postmoderne në qytetet tona po shoqërohet me një proces të thellë të braktisjes së shumë rregullave të ngurta sociale.

¹ Alia Izetbegoviç, “Islami ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit”, Prishtinë, 2015, f. 107.

Kjo tendencë qytetare është si një valë e fortë, që ka përfshirë tërësisht jetën në qytetet tona, mbi të gjitha, kjo tendencë ka filluar të marrë gjithçka me vete, duke filluar që nga ritualët e vjetër, ceremonialët e “ndryshkur”, si edhe shumë forma të jetës sociale, që në të kaluarën janë konsideruar të shenjtëruara në jetën qytetare. Shkodimi i jetës në qytet është produkt autentik i postmodernitetit, i cili, sikurse thonë sociologët, është etapë që nuk thërret asnjë besim apo shenjt për funksionimin e qytetit. Postmoderniteti ka vlerë absolute dhe ndikim kolosal në riformatimin e qyteteve, parimeve të jetës së tyre, sepse ai është “mjet që shkatërron besimet dhe ndalesat e vjetra, që nuk i shërbejnë kohës, që e kanë mbajtur njeriun në robëri shpirtërore apo ideologjike.

Natyrisht, në shoqërinë shqiptare, këto rrethana të reja sociale të jetës në qytet, kanë ndikuar në krijimin e marrëdhënieve ndryshe midis qytetarit dhe shoqërisë, midis shoqërisë dhe vetes. Në ditët tona po ngushtohen hapësirat sociale dhe po pakësohen kushtet sociale për ekzistencën e “qytetarit bashkëpunues”. Natyrisht, është tipologjia e qytetit dhe natyra e qytetërimit liberal, që më shumë nxit midis njerëzve garën individuale dhe më pak bashkëpunimin social.

Në këto kushte nuk është e udhës të ngremë ide që sjellin modele dhe skema utopike për jetën në qytet, dhe për një lloj qytetërimi që as ekziston e as ka shanse që do të vijë ndonjëherë. Qyteti dhe qytetërimi ynë tashmë është mbushur me qytetarë në garë, që edhe për pasojë do të jenë gjithnjë e më pak bashkëpunues midis tyre, në kuptimin e solidaritetit të vjetër social. Një model i tillë është i pamundur të ekzistojë në qytete dhe nuk ka mundësi reale që të qëndrojë në këmbë. Të mendosh se mund të ngremë “qytete utopike”, në të cilat zëvendësohet gara individuale me bashkëpunimin social midis njerëzve, është një lloj sikur të mendosh rikthimin e shoqërisë së turmës dhe modelit të jetës në qytetin e dikurshëm shqiptar, që ishin më së shumti “kazerma të përbashkëta”.

Në qytetet që jetojmë, realitetet janë pjesë e natyrshme e modaliteteve urbane e sociale të qytetërimit postmodern, me nuanca të forta individualizmi dhe asocialiteti. Kjo do të thotë se, në kohën e sotme, akoma më shumë është bërë e udhës që në jetën e qytetit të ngrihen më lart larmia dhe dallimet midis natyrës së qytetarëve sesa mundësia e ekzistencës së të përbashkëtës midis tyre. Në qytetet e sotme, qytetarët janë njerëz me natyrë njerëzore të ndryshme, me më pak mundësi për ndërtimin e një lloj qytetërimi, që të ketë në bazën e vet një natyrë plotësisht të përbashkët.

Është e vërtetuar tashmë në mënyrë të plotë, se në një qytet që ka brenda vetes një shoqëri liberale dhe njeriun individualist, sikurse është tashmë edhe shoqëria e sotme shqiptare, dëshirat, zgjedhjet dhe qëllimet e njeriut e kanë vendndodhjen te qeniet e veçanta. Kjo është një nga arsytet thelbësore pse qytetet moderne kanë marrë pamje dhe dimensione të reja.

Në këto kushte, sfera e jetës publike të qytetarit është boll e “mbiinstitutionalizuar” nga sistemet e qëndrueshme të referimit social. Te qytetari i kohës sonë “vërehet një kthim kah subjektiviteti njerëzor si dhe kuptimi dhe qëndrueshmëria kërkohen brenda vetes¹”. Qytetet dhe shoqëria shqiptare, në tërësi, kanë tashmë një realitet real dhe konceptual, ku mund të flitet për dukuritë që mund të jenë normale apo të jashtëzakonshme. Është bërë një dukuri intensive fakti që në shoqërinë jo vetëm shqiptare, por edhe përtej saj, edhe veprimet publike dhe ato me natyrë familjare po marrin gjithnjë e më shumë karakter personal dhe të individualizuar. Çdo njeri, edhe pse jeton në qytetin e përbashkët ose në familjen e tij, ka në të njëjtën kohë mënyrën e vet, ka standardet e personalizuara të komportimit social, të ndryshëm nga të tjerët që jetojnë në *Qytetin e përbashkët* apo në familjen e tyre.

Natyrisht, duket se nga ana tjetër ka një lidhje të fortë midis “boshllëkut shoqëror”, të krijuar nga jeta në qytet, e shfaqur në

¹ Anthony Giddens, “Pasojat e modernitetit”, Tiranë, 2013, f. 116.

parametrat e modernitetit post-materialist, sjelljeve të njeriut pa shumë dimension social. Në këto kushte duket se është kërkesë e vështirë të normativizosh sjelljen e njeriut në qytet, ta përshtasësh atë me kërkesat e jetës së përbashkët. Këto lidhje e mekanizma të jetës urbane në qytetet tona kanë filluar të zbehen. Sidomos në realitetet e reja mikrosociale të qyteteve tona. Prishja e strukturës sociale tradicionale të qytetit dhe shoqërimi i tij me procesin e urbanizimit të përshpejtuar, të sforcuar përmes kaosit të jetës shoqërore, janë procese që po sjellin pasoja të dukshme në formatimin e jetës, të shoqërisë dhe standardeve të qytetërimit tonë.

Ndërkaq, në qytetin e sotëm metropolitan, për shkak të ndryshimit të themeleve të jetës sociale nga jetë kolektive e detyruar në jetë të lirë dhe të individualizuar, ka bërë që të dëmtohen fort strukturat e jetës dhe të komunikimit social. Kjo është arsyeja pse në qytetet tona ndihen fort shfaqja e dukurive të reja, pothuaj të panjohura më parë, si p.sh. prishja e miqësisë tradicionale, dobësimi i lidhjeve të fqinjësisë, e shoqëruar kjo me dobësimin e ndjenjës komunitare. Shumë shqetësues është realiteti i ndryshuar i organizimeve bazë të jetës dhe funksionimit të institucioneve të saj. Në qytete janë bërë plotësisht të qarta dukuritë e dobësimit të familjes, prishjes së martesës dhe destruktimi i lidhjeve martesore, zgjerimi i konflikteve individuale, dhunës, krimit etj.

Është duke u thelluar atomizimi i lidhjeve sociale e qytetare në qytet. Kjo ka shpënë në deformime të dukshme me natyrë asociale të krejt “botës së qytetit”. Atomizimi i jetës në qytet është dukuri tipike, i cili bën që në mënyrë të natyrshme të jetë i pranishëm fenomeni i zbehjes së lidhjeve sociale, të dobësohet siguria individuale e njeriut. Në këto rrethana është e domosdoshme që ajo të kompensohet me besimin dhe lidhjet e ndërsjella, që njeriu krijon në familje, por dhe në institucione të tjera të sigurisë morale që funksionojnë në qytet. Vetëm aty ka shanse që të krijohet besimi te qyteti. Në qytetin e “atomizuar”, nëse masa e atomizimit të individit është në përmasa destruktive, atëherë ka shumë gjasa që njeriu, edhe pse jeton në qytet dhe është pjesë e tij, mund të jetë

para rrezikut të marginalizimit dhe vasalitetit social, sepse ashtu si ka thënë sociologu Ernest Gellner, urbanizimi zakonisht krijon popullata që jetojnë në rrethana të shthurura¹.

Po çfarë duhet bërë në mënyrë që të bindemi se rregullimi i qytetit, sidomos i strukturave të organizimit dhe forcimit të lidhjeve sociale, nuk mund të bëhet ndryshe, veçse duke punuar për të formuar qytetarin e lirë, të ndërgjegjshëm, i cili vullnetarisht dhe me vetëdije të plotë duhet të bëhet pjesë integrale e qyteteve tona. Kjo do të thotë se jeta sociale në qytet ka nevojë të diktojë disa norma që i ndihmojnë njerëzit të mësohen të ecin në jetë, duke u udhëhequr nga koncepti normativ i jetës në *Qytetin Modern*, që ka në themel idenë e vetëdijesimit, vetëvendosjes, realizimit të vetvetes si qytetar. Ekzistenca dhe rindërtimi i drejtë i këtij raporti, është baza e ekzistencës së qytetit, substanca e lidhjeve të tij me natyrën e *Njeriut Privat*.

Qyteti postmodern është “qytet tjetër”, që i përket asaj epoke, e cila nuk mund të zhvillohet pa pasur në bazën e vet, pa garantuar ekzistencën e pacenuar të sovranitetit të “individit privat”. Ky është hap më tej në ristrukturimin e qyteteve dhe jetës qytetare, të cilat u bënë të mundura nga shpikja e “individit privat, i cili është pronar i trupit të tij, i organeve të tij dhe zotërues i lirë i forcës së tij të punës”².

Urbanizimi dhe “lagjet e vështira”

Për realitetin tonë nuk është koncept sociologjik abstrakt fakti që, tashmë, gjithnjë e më shumë qytetet tona po strukturohen në mënyrë të tillë, që në to të ketë lagje periferike, me problematika sociale të veçanta në sasi dhe intensitet, që i bëjnë ato, për shumë arsye thelbësore, të quhen nga pikëpamja sociale “lagje të vështira”, që në njëfarë mënyre

¹ Ernest Gellner, “Konditat e lirisë”, Prishtinë, 2001, f. 296.

² Vincent Descombes, “Vetja dhe tjetri”, Tiranë, 2008, f. 240.

janë të njohura, të pranishme gati në çdo qytet të Shqipërisë. Ato janë bërë entitete sociale më vete, kanë tipologjinë e tyre të përcaktuar, mënyrën e strukturimit social, standarde të ngjashme të rregullimit ekonomik dhe të stratifikimit demografik.

Kjo është arsyeja pse lagjet periferike janë të shoqëruara me një problematikë ekonomike, sociale, demografike dhe kulturore të veçantë. Ato janë zona në të cilat ka disa veçori specifike, që vijnë nga mënyra e strukturimit gjeo-social, ndërtimit të strukturave ekonomike dhe funksionimit demografik. Në këto lagje, për shkaqe që dihen, ka më pak të ardhme, stabilitet social dhe harmoni qytetare, më pak kapital social të ndërtuar, të bazuara në ndjenjë të zbehtë komunitare. Rrjedhimisht, në këto lagje të vështira periferike, ka më shumë vështirësi ekonomike, konflikte, krime e turbulenca të njohura sociale.

Kjo situatë është e lidhur me shumë faktorë. Në këto zona periferike, të krijuara rishtazi me popullsi heterogjene, mungon “tutkalli social”, që duhet për rikrijimin e komunitetit dhe jetës qytetare mbi bazën e ndërtimit të komunitarizmit të ri, që duhet të jetë patjetër dhe me çdo kusht komunitarizëm qytetar. Megjithëse duket sikur lagjet e reja, ose ato që sociologjikisht mund t’i quajmë “lagje të vështira”, kanë prirje që demografisht të jenë homogjene, sepse janë të krijuara përgjithësisht nga banorë me origjinë të njëjtë, por përsëri uniteti, kohezioni dhe komunitarizmi i tyre është i dobët dhe ndonjëherë deri në nivele kritike. Kjo ndodh sepse ende një pjesë e tyre janë bërë zona sociale të vështira, të mbuluara nga varfëria, nga problemet sociale dhe konflikti.

Nëse bëjmë analiza të plota të situatës sociale të “lagjeve periferike”, në to ka tregues të qartë, që të mundësojnë idenë se në shumë raste periferitë e reja të krijuara nëpër qytete, jo vetëm janë bërë zona të vështira të penetrimit normal të standardeve të njohura të qytetërimit, por për disa arsye sociologjike, logjike, ekonomike dhe kulturore specifike, janë bërë hapësira në të cilat ndihet ndjenja e “përrjashtimit social”.

Sepse periferitë e lagjeve të qyteteve janë përbërë kryesisht nga njerëz të ardhur pas viteve ’90-të, dhe ato janë bërë të vështira jo se

të gjithë të ardhurit janë “njerëz të këqij” ose kanë prishur cilësinë e qytetërimit tonë, por sepse vështirësitë e jetës, pengesat e integritimit normal, janë të tilla, që e bëjnë të vështirë procesin e akomodimit social, integrimin ekonomik dhe akulturimin e shpejtë të tyre me standardet e qytetërimit modern.

Kjo është arsyeja që në këto lagje periferike të qyteteve ka më shumë varfëri dhe papunësi, mungesë të infrastrukturës sociale, rrugëve, kanalizimeve dhe institucioneve, më shumë braktisje të shkollës, më tepër “fëmijë të rrugës”, të cilët nuk janë rrugaçë, në kuptimin nominal, por janë fëmijë që bëjnë punë të këqija, që janë jashtë kufijve moshorë të tyre. Situatat e vështira të familjeve periferike periurbane i detyrojnë këta fëmijë që të mos ndjekin shkollën dhe rrjedhat normale të procesit të edukimit, por të detyrohen që të bëhen faktorë komplementarë për të sjellë të ardhura “themelore” apo “shtesë”, me qëllim që të mbajnë ekonomikisht familjet e tyre, të cilat për shkak të papunësisë apo mungesave të thella të aftësive për t’u integruar në tregun e punës, “detyrohen” të shfrytëzojnë në mënyrë të padrejtë punën e fëmijëve të brishtë.

Në këto lagje ka probleme dhe konflikte për çështje pronësie dhe probleme të tjera sociale. Në këto kushte, duket qartë se gradualisht në zonat periferike, në cilësinë e jetës së tyre po shfaqen disa dukuri të jetës sociale që duhen konsideruar dhe vlerësuar për t’i zgjidhur, duke ndihmuar popullsitë e ardhura në zonat periferike që të kenë mundësi dhe forca për t’i kapërcyer pengesat ekonomike, sociale, kulturore e të tjera, që janë pengesa të integritimit normal në rrjedhat e natyrshme të integritimit urban. Nuk është normale të mbyllim sytë përballë disa realiteteve që duhen njohur, përkundrazi, duhet të ndikojmë me masa të atilla që përmirësojnë kushtet e integritimit dhe të qytetërimit të popullsisë në këto lagje periferike.

Kjo është e domosdoshme sepse, në disa raste, në vend që të ecet në rrugën e integritimit urban dhe rindërtimit të përsheptuar të standardeve të qytetërimit, në këto lagje edhe pas dy dekadash e gjysmë, është

ende i dukshëm krijimi i dimensioneve të qarta të një lloj “nënkulture periferike”, e cila është bërë tipike për mënyrën e tyre të jetesës, *modus viventi*, i ngjashëm për të gjitha popullsitë e ngulura. Jo vetëm në zonat periferike të Tiranës, por edhe në qytete të tjera metropolitane.

Pa dyshim, duke vlerësuar përpjekjet për ndryshim të cilësisë së jetës dhe për integrim pa diferencim të kësaj pjese të popullsisë së ardhur, duket qartë se në pararojë të procesit të akulturimit, integritit dhe nivelimit të qytetërimit janë të rinjtë e kësaj popullsie, të cilët kanë më shumë aftësi adoptuese, ndjenjë të nxitur të integritit urban. Më bën përshtypje që të rinjtë e popullsisë të vendosura në lagjet periferike dhe në zonat periurbane, duket se kanë mendim më të qartë qytetërues.

Kjo është një dukuri sociologjike reale, që gjendet e pasqyruar në tendencat e të rinjve të këtyre zonave për të bërë jetë kulturore me standarde qytetare. Ata janë në rrugën e ndryshimit, krijimit të një nënkulture të re qytetare, që është e përshtatshme me statusin e ri të jetës së tyre, e dukshme edhe në gjëra që janë thelbësore, që kanë të bëjnë me ndryshime të thella të mënyrës së jetesës, higjienës, kulturës së komunikimit, ndryshimit të stilit dhe modeleve të veshjes, paraqitjes së jashtme, mënyrës së të ushqyerit, frekuentimit të *pub*-eve rinore, ushqimit modest nëpër *fast-food* etj.

Natyrisht, nuk është e lehtë që banorët e rinj të lagjeve periferike të ndihen në jetën urbane dhe në modelin qytetar të të jetuarit ashtu si në jetën me tipologji rurale që kanë bërë në fshat. Në fshat, ata kanë qenë të përshtatur me jetën rurale në mënyrë të përkryer dhe në ato ujëra ata notonin si “peshku në ujë”. Por vështirësitë e reja të jetës urbane e vështirësojnë akomodimin, socializimin dhe akulturimin e tyre. Ato nuk janë procese sociale të lehta, që kryhen vetiu, por duan vullnet, përpjekje të forta për të kapur nevojat dhe “ritmet tmerruese” të integritit urban.

Përpjekjet për të shmangur, ose më saktë për të zbutur “situatat marginale” të jetës së popullsisë periferike të lagjeve të vështira periurbane, janë pjesë përbërëse strategjike e planeve shtetërore,

programeve të pushtetit vendor dhe zhvillimit komunitar për të zbutur tendencat e rrezikshme, që këto lagje të mbeten jashtë ritmeve të integritit urban. Apo edhe më keq, që ato të vazhdojnë të përjetojnë situata që i ekstremizojnë në zona të “përjashtimit social”.

Procesi nuk është as i lehtë dhe, pa dyshim, ndryshimet nuk bëhen me lehtësi, sepse është një proces kompleks, që ka të bëjë me vështirësitë që kanë sjellë shpërnguljet pa kriterë të qarta urbane, bashkuar me pengesat e njohura të realizimit të procesit të akulturimit të tyre me kërkesat e reja të jetës qytetare. Koha ka shfaqur qartë, në jetën e qyteteve tona, nevojën sociale të përshpejtuar, që pas largimit nga zonat ku ata kishin siguruar identitetin e tyre të qartë rural, tani janë të detyruar të përshpejtojnë ritmet për të gjetur identitet të ri, apo siç mund të thuhet, të detyrohen të ecin me shpejtësi në rrugën e “ripërbërjes së identitetit” të ri qytetar. Vetëm kështu mund të zbuten problemet që kanë “lagjet e vështira” periferike. Ky është kusht *sine qua non*, që ato, në vend që të bëhen “lagje të vështira”, të jenë pjesë integrale dhe e natyrshme e jetës së përbashkët urbane të qyteteve tona.

Të ardhurit dhe patologjia e “egoistit autokton”

Modelet e strukturimit urban dhe të funksionimit social të qyteteve të kohës së komunizmit, kanë qenë nga më të shëmtuarat. Politikat urbane dhe demografike i kthyen qytetet në “bunkerë të mbyllur” për njerëzit, nga të cilat askush nuk mund të dilte dhe të hynte pa lejen e shtetit. Një model social arkaik, gati mesjetar. Sot gjërat kanë ndryshuar. Qytetet tona, me gjithë problemet sociale dhe defektet urbane që kanë, janë bërë, sidoqoftë, mjedise sociale ekonomike të hapura për të gjithë. Të paktën në kuptimin e së drejtës demografike dhe lirisë së banimit.

Liria u dha qyteteve zhvillim ekonomik, por të shoqëruar me kostot e “shthurjes urbane”, sepse qytetet vërtetë janë zhvilluar, por bashkë me zhvillimin edhe janë përfshirë nga kaosi demografik. Kjo simbiozë

është pasojë e faktit që në qytetet tona, për shkak të lëvizjeve urbane, struktura e qyteteve ka marrë një pamje dyfishë. Gati të ndarë, midis pjesës urbane dhe periferike, të cilat bëjnë që një pjesë e qytetarëve të ardhur, por urbanisht të paabsorbuar, të “ngulur” në qytet, por të paintegruar në jetën urbane sociale, jo rrallë e ndiejnë veten sikur jetojnë në mjediset e “qytetit përjashtues”. Nuk mjafton vetëm hapja politike dhe hapësinore e qytetit ndaj popullsisë fshatare. Procesi është kompleks, politik, ekonomik, social dhe kulturor.

Kjo është arsyeja që, edhe pse procesi i integritit të popullsisë fshatare gjeografikisht në territorin e qyteteve tona është proces i lirë, përsëri ndërtimi i tipologjisë së qytetërimit dhe problemet e bashkëjetesës së qytetarëve autoktonë me ata të “ardhur”, është bërë një simbiozë delikate, që ndihmon për të kuptuar thelbin e fshehtë të “qytetit përjashtues”. Nuk është shumë e vështirë të bëjmë dallimin midis qytetarëve të vjetër dhe qytetarëve të rinj, të cilët, pasi kanë ardhur në qytete, po përpiqen të integrohen në jetën qytetare. Të paktën me idenë se jeta e urbanizuar është kushti i parë i plotësimit të dëshirës për të kaluar kufirin e standardit minimal të jetës rurale.

Nuk është e drejtë që të ikësh pa qëllime dhe pa objektiva të qarta nga zona rurale e banimit drejt qytetit, pa marrë në konsideratë disa pasoja thelbësore që vijnë nga ky ndryshim, që nuk është thjesht gjeografik. Koncepti që ushqen idenë e jetës së denigruar të fshatit është i padobishëm dhe ekzibicional.

Ndryshimet e jetës rurale nga ajo urbane janë të njohura. Sepse, nëse në fshat jeta është më e thjeshtë, me organizim komunitar më të sigurt, jeta urbane i ka vendosur të ardhurit përballë sfidës së distancës shoqërore, sfidë që jeta në qytet ka në natyrën e vet thelbësore, që ka një format të ngushtë financiar, që nuk është aq tipik për jetën rurale dhe që është edhe natyror, edhe financiar. Në qytet të krijohet ideja se shkurtohen distancat fizike midis njerëzve, por në fakt zgjerohet distanca shoqërore dhe financiare midis banorëve. Ndërsa në fshat

mund të jenë më dukshme distancat fizike midis njerëzve, por janë më të afërta distancat që ruajnë lidhjet shpirtërore e komunitare midis tyre.

Në këto kushte duhet llogaritur mirë kostoja e jetës urbane, çmimi që duhet paguar në emër të qytetit dhe në emër të standardeve të përbashkëta të qytetërimit. Në jetën e sotme qytetare jo vetëm nuk ka kushte dallimi të origjinës regjionale të qytetarit të ardhur, por ka ikur përfundimisht koha e mentaliteteve diskriminuese, egoizmit qytetar për trajtimin diskriminues të diferencuar të popullsisë fshatare të ardhur nëpër qytetet tona.

Koha moderne në Shqipëri ka fshirë nga faqja e dheut modelin e vjetër të qyteteve si zona të purifikuara urbane, si mjedise me struktura gjeografike dhe urbane të mbyllura me “mure izolimi”, për të penguar penetrimin e fshatarëve. Tashmë gjërat duhen parë me optikën moderne, sepse ka marrë fund filozofia e trashëguar nga e kaluara, e bazuar në mentalitetin segregativ, sipas të cilës “fshatari nuk bëhet kurrë qytetar”. Por edhe pse janë kapërcyer paradigmat ekstreme të dallimit, të ndarjes, diferencimit dhe diskriminimit të popullsisë fshatare, për shkak të origjinës gjeografike dhe mentalitetit të jetës rurale, nuk mund të themi se kemi arritur gjithçka, se lidhjet, marrëdhëniet, relacionet midis fshatarëve dhe qytetarëve janë harmonike, normale, organike, pa ngarkesa diskriminuese dhe fare pa ndikim nga paragjykimet sociale të së kaluarës.

Nëse bëjmë një analizë më të hollë të situatës së këtyre marrëdhënieve, kuptohet lehtë që ende mentalitetet kanë mbetur. Ato shpesh janë si pranga nëpër këmbët tona, që na pengojnë optikën dhe arsyen e shëndoshë e sidomos kur me “egoizmin e qytetarit” gjykojmë ose paragjykojmë popullsinë fshatare të ardhur në qytet. Në të vërtetë, politikisht, gjeografikisht dhe demografikisht, qytetet janë të hapura për të gjithë. Lëvizja demografike me kah urban në Shqipëri, ka qenë në përmasat e një revolucioni të vërtetë demografik. Por kjo nuk do të thotë se sasia e procesit ka ndikuar në cilësinë e lidhjeve dhe marrëdhënieve të popullsisë autoktone me atë të ardhur. Realizmi

sociologjik nuk të lejon të mos dallosh atë që fshihet pas pamjes së qetë të këtyre marrëdhënieve.

Mentaliteti diferencues, shpesh diskriminues dhe mospëlqyes për fshatarët, ndoshta sot, nën ndikimin e peshës sociale dhe demografike të popullsisë së ardhur në qytetet tona, është bërë më finok. Pas këtij mentaliteti fshihet i maskuar qëndrimi refraktar, ndikimi në rikonceptimin e një modeli të heshtur përjashtues, që është i pranishëm si realitet social në qytetin shqiptar të kohës së sotme.

Qoftë në trajtën e vjetër gati obskurante, të bazuar në idenë e vjetër sipas së cilës “fshatari nuk bëhet kurrë qytetar”, e cila është e dalë boje nga koha dhe realitetet e bashkekzistencës dhe bashkëjetesës qytetare. Qytetet tona tashmë nuk kanë më tipologjinë e tyre të purifikuar, por janë bërë identitete të përziera urbane, me përbërje të popullsisë qytetare dhe fshatare, të lidhura në strukturat urbane të qytetit sipas imperativave që solli qytetërimi i lirë, koha moderne në Shqipëri.

Pa dyshim, ky “bombardim njerëzor” i qyteteve tona, i bërë në një kohë shumë të shkurtër, ka qenë proces socio-demografik shumë i shpejtë, intensiv, që e gjeti shtetin, shoqërinë dhe qytetet tona të papërgatitura për t’i përballuar këto flukse spontane. Ky ndryshim domosdo do të kishte ndikime dhe indikacione të natyrshme ekonomike e sociale, të cilat me siguri do t’i thyenin rregullat e vjetra të qytetërimit tradicional, do të ndryshonin tipologjinë tradicionale të qytetit si zonë urbane e izoluar dhe hermetikisht e mbyllur ndaj fshatit. Kjo kosto është e merituar për shoqërinë shqiptare.

Në vend që të lodhemi duke u marrë me gjykime dikotomike të përbërjes së popullsisë qytetare dhe me identitetet e trashëguara të qytetarit a të fshatarit, është e udhës të përpiqemi për të krijuar kushte urbane dhe sociale për integrimin normal qytetar dhe qytetëruës të masave të ardhura në qytet. Kjo bindje është e lidhur me mundësinë që të mendojmë duke u nisur nga e vërteta e pandryshuar, se përfundimisht qyteti, si politikisht, ekonomikisht ashtu dhe demografikisht, në shoqërinë shqiptare është “zonë e hapur” për lëvizje qytetare dhe

riorientime të masave urbane. Kjo është pjesa më thelbësore e së drejtës së qytetarisë të çdo shqiptari për të pasur legjitimitetin demokratik për të banuar kudo, qoftë qytetar apo fshatar.

Të mësohemi që në kohën e sotme, në qytetet tona nuk ka më hapësirë për njerëz që e mendojnë qytetin të ndarë në dy lloj habitatesh: një për popullsinë fshatare dhe një për popullsinë qytetare, ose në qytetarë të “dorës së parë” dhe “dorës së dytë”. Dallimet për shkak të origjinës apo të raporteve kohore me qytetin ose vendin e ri të banimit qytetar kanë marrë fund.

Duken qesharake dhe shpesh shqiptarët e bëjnë me humor dallimin e “qytetarëve të vjetër” nga “qytetarët e rinj”, që janë të ardhur në qytete pas viteve '90. Këto dallime mund të kenë vlerë demografike, ekonomike, kulturore e studimore, por nuk kanë asnjë tregues politik dhe social. Koha e imagjinuar nga “egoizmi qytetar” si mundësi lineare për të fituar apo rifituar të “drejtën e qytetarisë”, është një mentalitet tipik mesjetar, që jo vetëm është kundër kohës moderne, por tenton edhe të mbajë gjallë frymën e diskriminimit, që në fakt nuk ka asnjë vlerë në kohën e lirisë dhe të veprimit të standardeve të qytetërimit të hapur postmodern. Ai nuk ka pse të jetë egoist, të kundërshtojë të drejtën e integritit të lirë, por të qytetëruar të të tjerëve të ardhur në të.

Qyteti nuk ka pse bëhet paranojak dhe i prirë të “mbrohet” nga frika e ardhjes së qytetarëve të rinj. Kjo nuk ka asgjë të keqe në kushtet kur ata zbatojnë rregullat ligjore, kushtet urbane, të duhura për plotësimin e dëshirës humane të banimit në qytet. Liria dhe drejta e qytetarëve vendas, në këto kushte, nuk cenohet nga e drejta dhe liria e lëvizjes drejt qytetit të njerëzve të tjerë. Nuk është popullsia e ardhur nga fshati shkaku i vetëm që disa qytete janë transformuar, deformuar dhe në disa drejtime mund të kenë marrë “pamje fshati”, status të cilin “qytetari egoist” e ka të lehtë ta lidhë me vërshimin ose dyndjen e popullsisë fshatare drejt qyteteve tona.

Ata nuk kanë faj që nuk kemi plane paraprake e studime perspektive të zgjerimit të qyteteve, në mënyrë që këtë proces objektiv, që të na

imponohet me qëllim që të mos ia lëmë në dorë zhvillimeve kaotike, voluntarizmit dhe spontanitetit. E drejta e njeriut për të lëvizur dhe për të banuar ku të dojë, është një nga liritë dhe të drejtat universale, e cila nuk mund të kufizohet apo të rregullohet me paragjykime e restriktive pezhorative, por me politika dhe zgjidhje të parashikuara, për të realizuar absorbimin e qytetëruar të të ardhurve në rrjedhat e qytetërimit tonë të përbashkët.

Nuk është faji i fshatarëve të ardhur, nëse jeta në disa qytete ka filluar të humbasë cilësinë qytetare. Madje, është e vërtetë që në disa drejtime ka filluar edhe të fshatarizohet. Fajin që e kanë të tjerët, nuk ka pse në mënyrë abuzive ta interpretojmë dhe ta përdorim si “gjyle topi” mbi masat e të ardhurve nga fshati. Nuk ka pse të na pengojnë paragjykimet për të parë dhe për të vlerësuar në kompleks të vërtetat e këtij procesi social të vështirë, kontradiktor, progresiv dhe përkeqësues. Është e vërtetë që ka disa tregues të jetës urbane ku fshatarët dallohen, dhe kur kultura e tyre e trashëguar i pengon në rrugën e gjatë të integritimit qytetar, në mënyrën e duhur të të jetuarit, në përshtatje dhe në përputhje me kushte dhe kërkesa të jetës urbane.

Pa dyshim, në disa drejtime, ende ata që vijnë me nxitim në qytet, dallohen si “të ardhur”, dallohen në ecje edhe në sjelljet në vendet publike, në lokale, në mjediset urbane, në mungesën e respektimit të disiplinës komunitare. Ndonjëherë edhe në mangësitë higjienike personale dhe shtëpiake. Por të mos e bëjmë djallin më të zi se ç’është. Nuk na lejohet sociologjikisht të shohim vetëm njërën anë të medaljes, atë që duket më lehtë apo atë që kanë qejf disa “qytetarë egoistë”, që nuk duan të vlerësojnë ndryshimet sociale që ka bërë kjo popullsia e ardhur në qytet dhe që gjithnjë e më shumë po e tregon veten të integruar fare mirë me parametrat dhe standardet e jetës urbane.

Një pjesë e madhe e popullsisë fshatare është urbanizuar plotësisht, ka përmirësuar nivelin e jetës, cilësinë e shkollimit dhe aftësitë e punësimit. Kjo pjesë e popullsisë fshatare mbahet kulturalisht gjithnjë e më mirë dhe është përfshirë normalisht në jetën kulturore, sociale,

ekonomike të qytetit, duke kapërcyer me sukses atë të metë të jetës rurale, që sociologët e konsiderojnë si “ngathtësi të njeriut rural”.

Këta punojnë dhe janë bërë të shkathët në punë, në industri dhe në administratë, në sektorët e shërbimit dhe arsimit, në shëndetësi dhe ushtri. Një pjesë prej tyre kanë aftësi personale që të orientohen në tregun e punës dhe, meqë janë shumë punëtorë, kanë ngritur edhe bizneset e tyre, ndërsa fëmijët e tyre janë shumë të suksesshëm në shkolla dhe universitete. Kjo është ana tjetër e realitetit social që nuk duhet mohuar, që ka të bëjë me ritmet e përshpejtuara të integritit të kësaj popullsie në rrjedhat urbane të qyteteve dhe qytetërimit tonë.

Ideja e gabuar se ata e kanë të vështirë të përshtaten me kërkesat e qytetërimit dhe me standardet e jetës moderne qytetare, nuk janë të vërteta, ose janë pasojë e egoizmit qytetar, narcizmit urban, paragjyqimit diskriminues social. Të ardhurit nuk e kanë të vështirë t’i nënshtrohen vullnetarisht dhe me dëshirë procesit të mësimit dhe përshtatjes me rregullat e qytetërimit. Ata nuk kanë nevojë të “shtrohen me forcë”, sepse vërtet janë nga fshati apo të lindur fshatarë, por janë nga i njëjti brumë social dhe kanë të njëjtin gjen qytetërimi.

Qyteti nuk është vend për të bërë “duel qytetërimi” midis autoktonëve dhe të ardhurve. Përkundrazi, nga mënyra si janë rikompozuar qytetet nuk duhet t’i bëjmë hapësira për “duele identiteti”, por mjedise sociale për të ndërtuar së bashku “autoktonë” dhe të “ardhur” në hapësirat e përbashkëta qytetare me standarde qytetërimi, sepse nuk është lëvizja e duhur, koherente me kërkesat e qytetërimit, nëse me mentalitetin e “qytetarit egoist” ushqejmë ide të deformuara, që mund të na çojnë nga koha e qyteteve të “mbyllura” të komunizmit në qytetet marginalizuese e “përrjashtuese” të demokracisë.

Ka gjëra që janë përtej inateve dhe paragjyqimeve momentale, të përkohshme, sociale a personale. Lëvizjen e popullsisë, riorientimin, qoftë edhe të sforcuar urban, duhet ta shohim si hap përpara të qytetërimit tonë. Kjo është arsyeja pse sociologët e jetës urbane thonë se “shtrirja

gjeografike është forma e parë (që komandon të tjerat) e çdo zhvillimi ekonomie të një kombi, të një shteti, jo më pak të një qytetërimi¹”.

Qyteti i urbanizuar dhe “shtëpia e hapur”

Kam shkruar shpesh për raportet midis jetës intime të familjes dhe për rolin e shtëpisë si institucion social i jetës private dhe intimitetit. Në të vërtetë, është një arritje e madhe e qytetërimit tonë, që në këto dy dekada kemi mundur ta përkufizojmë më mirë, të vendosim “kufijtë” më qartë midis institucioneve të jetës intime dhe jetës sociale. Distancimi nga jeta sociale e dikurshme, nga shoqëria me privatësi dhe intimitet të cinguar, është një tregues i emancipimit të shpejtë, të cilin e ka marrë shoqëria jonë në dy dekadat e fundit. Tashmë nuk ka jetë sociale moderne, pa pasur në të njëjtën kohë raporte të qarta të njeriut me institucionet e jetës private dhe publike.

Ajo që më duket se është interesante nga pikëpamja sociologjike, por dhe me vlerë për organizmin e jetës empirike, ka të bëjë me një rivlerësim më të drejtë të “anëve” të ndryshuara të shtëpisë moderne, të raporteve të reja që kanë proceset sociale të “mbylljes” dhe të “hapjes” së saj në kohën e sotme. Është shumë interesante dukuria që ka “rrethuar” shtëpitë e shqiptarëve në kohën tonë.

Nga njëra anë, për sa i përket aspektit fizik, ato janë bërë mjedise akoma më të mbyllura, si kusht për të siguruar privatësinë dhe për të garantuar intimitetin e lidhjes së individëve, që jetojnë brenda saj dhe, nga ana tjetër, mjedisi i saj nga pikëpamja e mundësive të interferimit social është bërë shumë më e hapur sesa në të kaluarën.

Çfarë po ndodh me tipologjinë, me strukturën dhe me funksionet e shtëpisë?

¹ Fernard Braudel, “Gramatika e qytetërimit”, Tiranë, 2005, f. 455.

Jetojmë në kohë postmoderne, kur “pjesët” e jetës intime dhe private nuk janë më aq shumë të ndara me thikë, kur mjediset sociale dhe ato familjare tentojnë të afrohen dhe, në ndonjë aspekt, madje, edhe të “shkrihen”. Në këtë kontekst është njëra anë e problemit të konceptimit të rolit të shtëpisë si mjedis i mbyllur i familjes, i realizimit të jetës private dhe i plotësimit të natyrshëm të kërkesave të jetës intime të njeriut. Por, nga ana tjetër, shtëpia si institucion i jetës së personalizuar të njeriut po kalon një proces kontroversal, që tregon se sa më shumë intime bëhet së brendshmi, aq më shumë e hapur dhe e interferuar është ajo me ritmin, kërkesat, aksesorët dhe informacionin e jetës sociale.

Duke e vlerësuar sociologjikisht realitetin, raportet e shtëpisë dhe të jetës shoqërore, duhet ta pranojmë se shtëpia, krahas kushteve që ka për të siguruar dhe garantuar lidhjet e jetës intime dhe kohezionin e pjesëtarëve të familjes, në të njëjtën kohë dhe domosdoshmërisht po bëhet “qendër sociale”, ku njeriu mban lidhje dhe siguron komunikime sociale. Madje shpesh bën punë po aq sa edhe kur është në zyrë ose në çdo mjedis tjetër pune jashtë familjes.

Sociologët, kur duan të nënvizojnë këtë tipar të ri të shtëpisë postmoderne, thonë se tani kemi të bëjmë me një familje e cila jeton në një shtëpi private, por sipas sociologut dhe psikiatrit, Villi Pasini, është bërë mjedis i mbushur me tavolina dhe vegla pune, e “mbushur me kablllo” të komunikimit të zgjeruar masiv. Për këtë arsye në kohën tonë mjedisi ku jetojmë nuk është më “shtëpi e mbyllur”, por “shtëpi e hapur”. Natyrisht, shtëpia nuk është vetëm mjedis i vazhdimit të pandërprerë të punës dhe komunikimit të gjerë social. Teknologjitë e digjitalizuara e kanë bërë shtëpinë mjedis komod argëtimi, pse tashmë janë të gjitha kushtet e shndërrimit të saj në zyrë, në sallë teatri ose koncerti simfonik, galeri arti etj.

Ky dimension i hapur ndaj punës, komunikimit dhe argëtimit intensiv është bërë realitet për pjesëtarët e familjes përmes përdorimit të televizorëve me plazmë, të magnetofonave stereofonikë, videoregjistratorëve të sofistikuar, celularëve të diversifikuar dhe me

funksiione polivalente etj. Madje, tashmë, mjetet teknike të punës, komunikimit dhe argëtimit kanë rritur më shumë cilësinë e punës në shtëpi, shpejtësinë dhe vazhdimësinë e komunikimeve me të tjerët, cilësinë e transmetimeve artistike, argëtuese, zbavitëse dhe çlodhëse në familje.

Kështu, shtëpia është bërë një mjedis social i hapur dhe polivalent, meqë nuk është vetëm dhe thjesht një mjedis komod për argëtim dhe zbavitje, por në të vërtetë, duke parë mënyrën e organizimit të jetës, duket qartë që shtëpitë tona janë bërë shtojca të pandara të mjedisëve të punës. Shumica e njerëzve tashmë, në mënyrë fare të detyruar, nuk i ndërpresin kontaktet me punën edhe kur janë në shtëpi. Nëpunësit, intelektualët dhe njerëzit e botës së biznesit e mbajnë të hapur, *non stop* celularin, kompjuterin, lidhjet “on-line” të komunikimit social përmes internetit. Nga shtëpia jepen porosi për zbatim, bëhen shitje, dërgohen materiale në punë, shkrime për botim në gazeta apo për përdorime mediatike.

Ka njerëz që kohën e punës në shtëpi e kanë afërsisht të barabartë me kohën e angazhuar zyrtarisht në vendin e punës. Në njëfarë mënyre, duket që koha po përcakton ndryshime të thella në tipologjinë dhe mënyrën e realizimit të funksioneve tradicionale të shtëpisë. Shtëpia private po bëhet gradualisht “shtojcë besnike” e vazhdimit të procesit të punës, madje me po atë ritëm të lartë si në zyrë, në media apo në biznes.

Kjo situatë, që zhvillohet masivisht në shtëpitë tona, është tregues sintetik i së vërtetës; që jeta intime me jetën sociale nuk janë më të ndara me “mur betoni” as në një mjedis të tillë privat të njeriut, siç është shtëpia e tij. Kjo tregon se tashmë jeta sociale dhe jeta personale janë bërë më të integruara dhe se shtëpia është vënë më shumë në funksione sociale duke i shërbyer punës, suksesit, fitimit, famës etj.

Kjo tipologji e jetës postmoderne jo vetëm e ka bërë shtëpinë mjedis të hapur social, por natyrshëm dhe mjedis shtesë për të realizuar vazhdimin e plotësimin të qëllimeve utilitare të personalizuara të jetës së njeriut. Jeta, moderniteti, intensiteti social, i ka thyer “kufijtë” e ndarjes

së shtëpisë si mjedis privat dhe punës si mjedis social. Ato sot janë afruar më shumë se kurrë me njëra-tjetrën, madje deri në ato përmasa, saqë është bërë fare konvencionale ndarja e tyre. Nëse do ta vlerësojmë këtë lidhje, duhet të pranojmë se në këtë aspekt mezi dallohet (jo nga pamja, por nga thelbi) se ku fillon mjedisi i hapur i punës dhe ku mbaron mjedisi i mbyllur i shtëpisë.

Në kohën tonë këto interferime të mjediseve private dhe sociale janë në zgjerim. Madje duhet pranuar se përzierja e territoreve të punës me mjedisin e shtëpisë, me mjediset e jetës publike e sociale dhe me ato intime, tashmë është tendencë që po zgjerohet dhe masivizohet në Shqipëri. Nuk është rastësi shpejtësia maksimale e përhapjes së internetit në familje, pa folur për celularët, që tashmë janë masivizuar në mënyrë ekstreme. Sociologët, duke parë dhe vlerësuar këtë dukuri të afrimit apo “shkrirjes” së shtëpisë me botën e punës, të mjediseve private me ato publike, përpiqen të gjejnë shkaqet dhe të bëjnë prognoza se deri ku do të shkojë ky proces në të ardhmen.

Këtë tendencë e vlerësojnë në mënyrë të shumanshme, por pa harruar të theksojnë të ashtuquajturën “dhunë të shoqërisë industriale”, e cila ka penetruar edhe në shtëpitë tona, duke na mbajtur të karikuar edhe në çastet e jetës intime, në kohën e pushimit dhe të argëtimit, si edhe gjatë çlodhjes në mjediset private familjare.

Sot jemi të detyruar të jetojmë e të përshtatemi me jetën intensive pa pushim dhe çlodhje, sepse, siç thonë filozofët e Shkollës së Frankfurtit, Adorno dhe Horkheimer, kjo jetë “... i mban të gjithë, që prej fillimit, në tendosje, si gjatë punës, ashtu edhe në çastet e pushimit”¹.

Duam apo nuk duam, kjo është tipologjia që ka marrë në mënyrë të “detyruar” shtëpia postmoderne. Sepse, megjithëse si shtëpi është strehëz e mbyllur e jetës private, edhe pse është mjedisi i përshtatshëm i organizimit të jetës intime, duket se prirja në shoqërinë tonë është e

¹ Teodor Adorno, Max Horkheimer, “Dialektika e iluminizmit”, Tiranë, 2009, f. 206.

tillë, që e detyron njeriun të pranojë si detyrim të kohës nevojën që të mësohet, të përshtatet me strukturën, fizionominë dhe funksionet e ndryshuara të “shtëpisë së hapur”, familjes dinamike, komunikuese me mjedisin social. Jo vetëm në kuptimin e përgjithshëm sociologjik, por edhe në kuptimin empirik dhe “teknologjik”.

Jeta urbane, interneti dhe shoqëria reale

Në shoqërinë shqiptare po bëhen gjithmonë e më të pranishme realitete të reja sociale, që kanë lidhje me rindërtimin e tipologjisë së lidhjeve individuale dhe të marrëdhënieve sociale. Kanë ndryshuar shumë gjëra që kanë të bëjnë me përpjekjet sociale, për të vendosur dhe institucionalizuar lidhjet midis njeriut konkret, individit të përveçëm dhe nevojave të modernitetit për organizimin e komunitetit të njerëzve, që në kohën e sotme më shumë janë virtuale, të realizuara me njerëz të lidhur nëpërmjet rrjeteve sociale.

Në të vërtetë, këto janë probleme të reja sociale me të cilat po përballet jo vetëm shoqëria jonë, por e gjithë shoqëria njerëzore, globalisht. Kjo është arsyeja që në debatet që zhvillohen sot në vendin tonë, për raportet e njeriut me komunikimin elektronik dhe lidhjet në rrjetet sociale, shpesh ka keqkuptime, herë individuale, por në shumë raste me përmasa sociale.

Kjo ndodh për shkak të shfaqjes së bujshme të tendencës së thellë të individualizimit dhe zgjerimit të mënyrave të personalizuara të jetës sociale. Kështu që duhet bërë kujdes kur duam të dallojmë kurbën, shkaqet e një tendence të fortë sociale, siç është individualizmi. Qoftë si shprehje elokumente e modernitetit social në Shqipëri, ose e vlerësimit koherent dhe objektiv të realiteteve tona. Problemi është që, sa kjo tendencë e modernitetit individualist të shoqërisë, zgjerimi i thellimit të “invidiumit të individit” është i lidhur me zgjerimin e rrjetit social,

shumëfishimin e mundësive të komunikimeve personale, individuale, të personalizuar përmes internetit dhe rrjeteve të komunikimit social.

Pyetja që shtrohet është: a është niveli i sotëm i shfaqjes së individualizmit i lidhur me fuqinë e rrjeteve sociale, apo individualizmi në shoqërinë e sotme shqiptare është një realitet sociologjik, që nuk është vetëm pasojë e internetit, por e prirjes së përgjithshme të kohës dhe natyrës individualiste si esencë e postmodernitetit social?

Nga disa sociologë mendohet se zhvillimi i internetit, zgjerimi i mundësisë së rrjeteve të komunikimit social është gjetur si “antidot elektronik”, për të luftuar apo për të sulmuar individualizmin e thellë të jetës së njeriut që, siç duket qartë tashmë edhe në shoqërinë tonë, tenton të bëjë stil të jetës mënyrën e përveçme, gjithnjë e më të izoluar nga lidhjet dhe komunikimet sociale. Në njëfarë mënyre, njerëzit nëpërmjet internetit dhe rrjeteve sociale përpiqen të kompensojnë virtualisht atë sasi të lidhjeve sociale dhe të komunikimeve ndërpersonale të munguara, të cilat nuk i realizojnë dot në jetën e përditshme reale.

Zgjerimi i internetit, shumëfishimi i përdorimit të lidhjeve njerëzore përmes rrjeteve sociale, është reagim i sforcuar elektronik që tashmë është bërë i mundur dhe i realizuar në “shtëpitë me kablo”, si mënyrë e tërthortë për të “korrigjuar” disa nga patologjitë e shoqërisë postmoderne.

Duhet të pranojmë se tashmë në shoqërinë shqiptare shfaqen dukshëm dhe janë të hapura të mirat dhe defektet e postmodernitetit. Ato i kanë dhënë shoqërisë së sotme atë format social, që shpesh njeriut i duket herë realitet indiferent e pastaj mjedis armiqësor ndaj “fatit të tij”. Nga ana tjetër, qytetërimi i sotëm shqiptar nuk mund të jetë jashtë prirjes së thellë universale të shoqërisë postmoderne, ku në mënyrë të natyrshme janë reduktuar dimensionet dhe veprimet sociale, duke i larguar njerëzit nga angazhimet e gjera qytetare ose nga veprimet me “lëvizje kolektive”, që në të kaluarën janë konsideruar si mënyra e vetme për të ndryshuar ose për të përmirësuar gjërat që ndodhin në shoqëri.

Koha ka krijuar problemet e veta. Shqiptarët po binden gjithnjë e më shumë se zgjidhjet e problemeve sociale me reagime kolektive ose veprime super sociale janë të pamundura. Në kohën tonë, problemet kanë ndryshuar kahun, mënyrat e zgjidhjes, sepse shumë gjëra nuk mund të zgjidhen duke pretenduar të “reformojmë shoqërinë”, për ta kaluar atë nga indiferenca qytetare në reagimin civil dhe angazhimin qytetar, por nëpërmjet reagimit dhe angazhimit individual të qytetarit si individ.

Në këtë kontekst, hapësira e internetit dhe zgjerimi i komunikimeve përmes rrjeteve sociale, është duke u përdorur jo vetëm në komunikimet dhe lidhjet individuale, por edhe në formatin e reagimit sociologjik. Duke e vlerësuar sociologjikisht këtë realitet duhet të kuptojmë të vërtetën që po ndodh në shoqëri, e cila ka prirjen jo aq të bazohet te shoqëria dhe te zgjidhjet sociale, por të kërkojë zgjidhje duke u “qendëruar tek individit” si qytetar.

Kjo është arsyeja që për të angazhuar qytetarin në çështjet e jetës sociale, në zgjidhjen e problemeve qytetare, kemi filluar të besojmë në mundësitë e gjera që krijojnë rrjetet sociale, përmes komunikimit të shqetësimeve individuale e të krijojmë kushte sa më ndikuese për të zhvilluar reagimin social qytetar. Kjo është arsyeja pse shpeshherë na duket sikur po ecim më shpejt, jo aq nëpërmjet shoqërisë reale sesa duke krijuar komunitete, lidhje e ndërvarësi të forta virtuale.

Sociologët që studiojnë fenomenet e epokës postmoderne, fenomenologjinë e jetës elektronike, dukurinë sociale intensive të përzierjes globale të qytetarëve në sistemet e shumta të rrjeteve që mundësojnë lidhjet sociale midis qytetarëve dhe tipologjinë e rrjeteve virtuale mikrokombëtare, mendojnë se kjo rrugë, edhe pse jo pa të meta, është bërë realitet i duhur social dhe, derisa kemi një publik social indiferent, është e sigurt që do të zgjerohet baza e fenomenit social të krijimit të qytetarisë me bazament të fortë individual, gjithnjë e më shumë me “rrenjë të shkulura” sociale.

Komunikimi, dialogu, ndihma që qytetarët kërkojnë përmes komunikimeve në rrjetet sociale, është e lidhur me nevojën e krijimit të “komuniteteve virtuale”, që krijohen nga lidhjet në “site” me njëritjetrin, për të krijuar opinion apo për të pasur ndikim virtual në jetën sociale dhe veprimtarinë publike. Në të vërtetë, lidhjet e qytetarëve përmes internetit, nuk është se kanë ndonjë sukses të vërtetë me ndikime reale në jetën sociale.

Ndoshta ngaqë këto lidhje sociale elektronike më shumë bëhen lidhje për motive banale, shpesh me mesazhe të kota sociale, herë me natyrë të përgjithshme dhe, në shumë raste, me prirje për konformizëm social. Në të vërtetë, beteja për krijimin e komuniteteve virtuale, përmes internetit dhe lidhjeve përmes kanaleve të rrjeteve sociale, është dukuri e lidhur me faktin që zhvillimet që po ndodhin në shoqërinë shqiptare kanë sjellë realitete të reja, që tregojnë se koha është faktor madhor, e cila i zbeh gjithnjë e më shumë lidhjet praktike, sidomos format e vjetra tradicionale të solidaritetit njerëzor.

Por, pavarësisht arritjeve dhe ndikimeve që ka interneti, fuqisë evidente të rrjeteve të komunikimit social, është e pamundur që ato të mund të bëjnë të “tepërt” apo të zëvendësojnë nevojën e njerëzve për lidhje të vërteta sociale, për ndërtimin dhe funksionimin e solidaritetit komunitar, si lidhje konkrete me natyrë humane dhe me ndikim të vërtetë social. Rrjeti i komunikimeve sociale dhe lidhjet elektronike kanë vlerën e tyre, e cila, sidoqoftë, nga pikëpamja e ndikimit social të vërtetë është e kufizuar. Kjo është arsyeja që hapësira e përdorimit të internetit, fusha e zgjeruar e lidhjeve sociale, të cilat realizohen përmes rrjeteve sociale, nuk mund të bëhen “hapësirë zëvendësuese”, mënyrë për të kompensuar mungesat e funksionimit të komunitetit dhe lidhjeve sociale reale midis njerëzve, por edhe të lidhjeve ndërpersonale apo nevojës së natyrshme për një nivel të caktuar të solidaritetit human. Njerëzit nuk mund ta mbajnë shoqërinë në këmbë, nuk mund të organizojnë komunitete duke i pasur lidhjet njerëzore vetëm virtualisht, që ata të shndërrohen nga qenie të gjalla aktive, në adresa të ftohta

elektronike, me të cilat lidhemi dhe komunikojmë për gjëra që janë qoftë virtuale apo për interesime sociale periferike. Shoqëritë virtuale në rrjetin social nuk e zëvendësojnë rolin e shoqërisë reale, aq më pak vlerën e pazëvendësueshme që kanë marrëdhëniet e vërteta njerëzore. Kjo sepse, në shumë raste, komunitetet e krijuara përmes rrjetit social jo vetëm që janë komunitete virtuale, të paqarta dhe të pakonturuara nga pikëpamja sociale, por janë komunitete të njerëzve pa “territor”, ose, siç konsiderohen në sociologji, “shoqëri të shterritorializuara”.

Pa dyshim, zgjerimi i lidhjeve të njerëzve përmes rrjetit social është shkak i individualizmit, pasojë që e zgjeron mënyrën individuale të të vepruarit. Në këtë kontekst, lidhjet individuale elektronike nuk janë kurrë të mjaftueshme për të krijuar komunitete qytetare të qëndrueshme, sepse komunitetet virtuale të krijuara elektronikisht nuk kanë lidhje të qëndrueshme, nuk kanë norma sociale të veprimit të kompaktësuar social, nuk njohin peshën e trysnisë sociale për të vepruar në mënyrë komunitare.

Është e evidente, që interneti dhe lidhjet e personalizuara në rrjetet sociale janë forma që nxisin akoma më shumë përhapjen e individualizmit ekstrem. Komunitetet virtuale nuk janë lidhje të qëndrueshme. Njerëzit janë më shumë të lidhur midis tyre me adresa elektronike, por që shfaqen dhe shuhën pa lënë gjurmë të mëdha sociale. Ideja se kjo është mënyra më e mirë e afirmimit të personalitetit individual, shijeve, hobeve, mendimeve personale, që realizohen duke vendosur kontakte me të tjerët përmes rrjetit social, konsiderohet mënyra ultramoderne e socializimit të njeriut të kohës sonë.

Në të vërtetë, më shumë se afirmim të individit, rrjeti social mundëson “çmishërimin” e tij, sepse duke e bazuar tërësinë e lidhjeve sociale vetëm mbi bazën e rrjeteve elektronike, individi bëhet abstrakt ose i nominuar thjesht nga një adresë elektronike, që në fakt e mban larg lidhjeve sociale dhe realitetit të vërtetë jetik.

Sipas sociologut Oliver Roy, “individualizmi nuk sjell, pra, një diversifikim të përsiatjes dhe të mendimit, as një thellim të krizës,

por më shumë një vetëkonfirmim të konformizmit, një kërkim të një bashkëpëlqimi normativ. Individualizëm nuk do të thotë krijimtari: ka përsëritje të ortodoksisë më fort sesa paraqitje idesh vetjake¹”.

Është iluzion i keq besimi se rrjetet sociale janë mjet i mjaftueshëm për ta nxjerrë njeriun nga “izolimi sociologjik” apo që ato krijojnë mundësi dhe shanse për të pasur marrëdhënie sociale të mjaftueshme. Nuk mund të bëhet shoqëria me komunitete virtuale, me “grumbuj individësh” që kanë vetëm lidhje elektronike, por nuk kanë lidhje konkrete midis tyre. Me gjithë vlerën që mund të kenë lidhjet në internet, marrëdhëniet në rrjetin social, sidoqoftë, mbeten lidhje që janë jashtë “shoqërisë reale”, larg marrëdhënieve të vërteta sociale.

Komunikimi dhe hapësira publike urbane

Zgjerimi i përdorimit të internetit ka bërë të mundur zgjerimin e formave të lidhjes elektronike dhe demokratizimin e rrjeteve të komunikimit social në Shqipëri. Këto janë realitete të reja, që intensivisht kanë ndryshuar raportet e individit me veten, të tjerët dhe shoqërinë në tërësi. Megjithëse të rinj në këtë hapësirë të re të komunikimit elektronik dhe përfshirjes së njerëzve në rrjetet e komunikimit social, zhvillimet e ndodhura në Shqipëri në mënyrë të natyrshme kanë sjellë një situatë të re në komunikimet publike dhe private, të cilat kanë krijuar shqetësime që janë shoqëruar me një varg problemesh të vështira në jetën sociale.

Nuk është rastësi që një arritje kaq e madhe e komunikimit njerëzor nëpërmjet rrjeteve sociale, që është bërë përparësi e zgjerimit të komunikimeve ndërpersonale dhe publike, po shoqërohet me shumë probleme sociale dhe me paqartësi që ndikojnë në jetën e qytetarëve tanë, në atmosferën sociale të shoqërisë sonë, por sidomos kontroversat, paqartësitë dhe problemet janë përqendruar te raporti që kanë me

¹ Oliver Roy, “Islami i globalizuar”, Tiranë, 2009, f. 186.

rrjetet sociale të rinjtë, pasioni i të cilëve, për të qenë të “lidhur” dhe vazhdimisht në komunikimin nëpërmjet rrjeteve sociale, është bërë fenomeni social më masiv, dukuri e zgjeruar në përmasa gati epidemike, fenomen që vështirë të zbutet, pa le më të pretendosh që të shmanget.

Nëse ka një arritje që të gëzon, është fakti që interneti e ka demokratizuar kulturën dhe informacionin, që janë bërë fusha të hapura për të gjithë qytetarët. Në njëfarë mënyre, rrjeti i komunikimeve sociale ka bërë revolucion të vërtetë në fushën e komunikimeve private dhe publike, personale dhe sociale. Kjo, sepse është shmangur, nga njëra anë censura, që e ka bërë informacionin të lirë, por nga ana tjetër, në komunikimet e sotme është zbehur kufiri dhe mundësia që të garantosh privatësinë individuale dhe intimitetin personal.

Në këtë situatë të demokratizimit të lidhjeve sociale dhe zgjerimit të informacionit që qarkullon nëpërmjet rrjeteve sociale, patjetër që mund të ketë të “humbur” dhe të “fituar”. Sepse, nga njëra anë, shteti ka humbur të drejtën e censurës dhe është bërë krejt i pafuqishëm në kontrollin e informacionit që rrjedh në rrjetin social, i cili mund të jetë pro, por mund të jetë edhe kundër tij, mund të jetë mbështetës për politikën e qeverisë, por mund të shërbejë edhe si mjet i grumbullimit të njerëzve që janë kundër politikave të saj.

Qarkullimi i lirë i ideve dhe i informacioneve, diskutimi i tyre i lirë, i hapur dhe jashtë çdo hierarkie shtetërore është një nga epërsitë e revolucionit të internetit, forcës gjithëpërfshirëse të rrjeteve sociale. Interneti po u shërben të gjithëve, kujtdo që dëshiron të dijë dhe të mësojë, dijetarit dhe qytetarit, shkencëtarit dhe transmetuesit të dijeve (mësuesit ose pedagogut), të gjithë atyre që kanë mundësi dhe që dinë ta përdorin këtë medium të fortë, dhe rrjetet e shumta të komunikimeve sociale.

Fenomeni i rrjetëzimit të informacionit dhe i lidhjeve sociale nuk është i thjeshtë dhe nuk duhet vlerësuar në mënyrë të thjeshtëzuar, dhe nuk duhet parë në nivelin e thjeshtë të inovitetit teknologjik të komunikimit. Problemi është më i thellë, me përmbajtje sociologjike

dhe me sfond të zgjeruar në ndikimet që ka në jetën publike qytetare. Zgjerimi dhe përhapja e dijes, demokratizimi i informacionit të hapur, përdorimi gjithnjë e më shumë në nivel individual, zgjerimi i hapësirës së komunikimeve të hapura dhe diskutimeve publike, duhen konsideruar vetëm në qoftë se i shikojmë të lidhura, i vlerësojmë në funksion të pasojave evidente, që kanë sjellë teknologjitë e reja në botën e sotme të globalizuar.

Nëse do t'i vlerësojmë në mënyrë dialektike dhe jo në mënyrë të njëanshme të mirat dhe të metat e përdorimit të informacionit të gjithanshëm, që vjen prej internetit, do të kuptojmë se jemi në kohën kur edhe në shoqërinë tonë po shfaqet e meta e parë e madhe, që ka të bëjë me faktin që interneti dhe rrjetet sociale janë bërë “imperialistët” më përcaktues të informacionit që qarkullon, të “lëndës” që është disponibël për të gjithë qytetarët pa dallim.

Pa mohuar vlerën e madhe që ka kjo mënyrë e qarkullimit dhe e gjetjes së informacionit, sociologët e fushës, duke vlerësuar epërsitë e këtij lloji transmetimi të ideve, njohurive dhe informacioneve në nivel social, kanë mundur të diktojnë defektet e mundshme, të pashmangshme të lidhjeve të fiksuara të njeriut të sotëm pas informacionit virtual, që vjen prej internetit dhe rrjeteve sociale. Nuk mund të mos dallojmë se nën ndikimin e tyre, sot po përballemi me dukuri të tilla sociologjike, siç janë “homogjenizimi i informacionit”, “thjeshtësia relative e njohurive” që transmetohen, “kalibrimi” përmes përsëritjes dhe mundësive të ritransmetimit etj. Në internet dhe në rrjetet sociale janë të gjitha mundësitë që i njëjti mesazh të dëgjohet, të transmetohet dhe ritransmetohet, të përhapet, të diskutohet në rrjet dhe, në njëfarëmënyre, bëhet “shkak detyrues” për njerëzit që të marrin pjesë në debate virtuale dhe të prononcohen për atë që është bërë objekt debati publik.

Besoj se duhet të tregohemi të arsyeshëm dhe më të kujdesshëm sidomos me fëmijët dhe me të rinjtë, që statistikisht janë përdoruesit më të gjerë të internetit dhe të rrjeteve sociale në Shqipëri. Këta janë fiksuar pas informacionit të lehtë elektronik, mbushjes plot e përplot të

sferës së komunikimeve personale në lidhje pa fund, pa vlera të forta edukative dhe, nganjëherë, problematike për moralin dhe personalitetin e tyre. Prindërit, mësuesit, edukatorët dhe kushdo që ka autoritet mbi të rinjtë, duhet të ndihmojë që të vendosen raporte më të drejta mes tyre dhe internetit dhe rrjeteve sociale, të cilat nuk mund të mohojnë dhe të spostojnë format e tjera të marrjes së njohurive dhe mënyrave jovirtuale, por reale të lidhjeve sociale.

Epërsia e informacionit, që vjen nga interneti, dhe shpejtësia e vendosjes së lidhjeve dhe komunikimeve sociale të personalizuar nuk duhet idolatrizuar, aq më pak nuk duhet konsideruar se është gjithçka në sistemin e sotëm të komunikimit njerëzor. Besimi i deformuar te disa të rinj, por jo vetëm, se interneti mund të zëvendësojë format, burimet dhe mënyrat e tjera të sigurimit të informacionit, është krejt i gabuar, pa ndjenjën e duhur të perceptimit dhe të vlerësimit të duhur intelektual. Në përmbajtjen e lëndës, që qarkullon në internet, mund të jetë epërsia e shpejtësisë, e informacionit të shpejtë e të kondensuar, që të ndihmon dhe, për momentin, të “nxjerr nga halli”.

Sociologët e kohës sonë mendojnë se, për sa i përket thellësisë, informacioni në internet është i varfër, nuk ka bazë të fortë historike, nuk i përfshin të gjitha sferat e debatit të zhvilluar linearisht për një temë të caktuar.

Megjithatë, duhet t’i njohim dhe t’i pranojmë realitetet sociale që po zhvillohen në vendin tonë. Jemi në etapën e zhvillimeve postmoderne, kur rrjetet sociale janë bërë mënyra të zgjeruara të komunikimit, që gjithnjë e më shumë përdoren nga njerëzit për qëllime të shumta, të larmishme, të lidhjeve dhe komunikimeve individuale dhe sociale. Edhe pse debatet dhe diskutimet që zhvillohen në rrjet, po t’i shohësh me vëmendje, janë të sipërfaqshme, më shumë për gjëra të modës, për probleme kalimtare, që nuk sjellin ndonjë orientim të qëndrueshëm të pjesëmarrësve në diskutim.

Nëse vlerëson tipologjinë e debateve, format e diskutimeve, që zhvillohen në rrjetin social, do të ndiesh nevojat komerciale dhe

pragmatiste të politikës së ditës dhe në raste të shumta do të përballesh me debate rastësore, herë të personalizuara dhe herë për modë sociale. Ende nuk ka shenja serioze, që për tema të caktuara me interes publik, që zhvillohen në rrjetin social, debatuesit të bashkohen qytetarisht si pjesëmarrës për të diskutuar publikisht një çështje me rëndësi të jetës publike me formatin e njohur të “klubit të diskutimeve” qytetare.

Pa dyshim, nëse do ta shihnim nga pikëpamja e vlerës sociale, si raport midis kostos dhe përfitimit, nuk mund të mohojmë vlerën e shtuar të rrjetit të komunikimit social. Por në të njëjtën kohë nuk mund të mos nxjerrim në pah të vërtetën, që shumica e “site”-ve kanë një format naiv e dogmatik, në të cilat më shumë se informacion social ka sharje, shpifje, fyerje, informacion intim të panevojshëm, të paverifikuar. Tiparet e këtij tipi shkëmbimesh informacioni në rrjetet sociale, në shumë raste kanë sjellë problematika sociale, grindje, mëri, neurotizëm, pse jo edhe forma verbale, psikologjike e fizike të dhunës individuale.

Megjithatë, nëse këtë fenomen do ta shohim më gjerë, do ta vlerësojmë si një mundësi për lidhje të pakufizuara në kohë dhe hapësirë, duhet të pranojmë dobinë e madhe që kanë sjellë interneti dhe intensiteti i funksionimit të rrjeteve të lidhjeve dhe komunikimeve sociale.

Praktikisht, njerëzit tanë, duke qenë pjesëmarrës të rrjeteve sociale, kanë sjellë një dukuri të fortë të “homogjenizimit qytetar” përballë njohurive dhe informacionit. Interneti dhe rrjetet sociale, edhe në vendin tonë, kanë krijuar mundësinë e përfshirjes së qytetarëve tanë në botën globale dhe në kategorinë sociale të njerëzve të “lidhur pa territor” ose, si konsiderohen në sociologjinë e postmodernitetit, “qytetarëve të shterritorializuar”, që përmes rrjetit të komunikimeve sociale përpiqen të ndërtojnë “shoqëri virtuale”, që duam apo nuk duam sot është bërë e modës.

E, megjithatë, edhe kjo arritje e madhe teknologjike, me efekte sociale shoqëruese, ka kufizimet e veta, njohja e të cilave është kusht për të orientuar veten, njeriun dhe shoqërinë me jetën reale dhe realitetet

virtuale elektronike, sepse sipas Oliver Roy-t, drejtor i Shkollës së Studimeve të Larta në Paris, “kjo shoqëri virtuale paraqet më shumë një kërkesë identitare sesa një vullnet për të ndërtuar ose për të vepruar. Ajo është, përveç kësaj, vendi i nxitjes, që nuk pasohet me veprime. Nuk ka çështje konkrete politike ose sociale për të cilat luhet. Është një mendim metaforik”¹.

Njeriu urban:jeta private dhe detyra publike

Shoqëria jonë ka shqetësime sociale të shumta, një pjesë prej të cilave të lidhura dhe të justifikuar nga e kaluara historike, të cilat në shumë drejtime janë bërë të mprehta dhe të agravuara. Sasia dhe intensiteti i tyre më së shumti është i lidhur me relacionet e reja, të krijuara midis njeriut dhe shoqërisë nga ndryshimi i kushteve ekonomike, morale dhe sociale. Në këtë kontekst, ne po përballemi me probleme social-ekonomike, me varfëri ende të lartë, me probleme të thella në mënyrën si është organizuar jeta urbane, si funksionojnë familja dhe komuniteti urban. Këto shqetësime të jetës urbane vijnë nga deformimi dhe shpërdorimi i konceptit të vërtetë të lirisë, nga ndikimet e forta që ka sjellë natyra e ndryshuar e njeriut urban, nga relacionet kakofonike që ai po ndërton me veten, me familjen dhe me shoqërinë.

Në fakt, po kalojmë një gjendje sociale të vështirë, shpesh shqetësuese, dhe jo të lehtë për t’u justifikuar nga pikëpamja e modeleve urbane të të jetuarit. Ka tregues socialë evidentë, që flasin për një “gjendje të sëmurë” të shoqërisë, për situatë të nderë në marrëdhëniet e njeriut dhe shoqërisë, sidomos me ato marrëdhënie që kanë të bëjnë me raportet e shpërpjesëtuara të komponentëve esencialë të jetës urbane publike, private dhe intime. Realisht, të gjithë jemi të shqetësuar për këtë situatë, sepse këto relacione të ndërlikuara të njeriut me “veten”, “tjetrin” dhe

¹ Oliver Roy, “Islami i globalizuar”, Tiranë, 2009, f. 171.

shoqërinë nuk kanë qenë kurrë kaq të ndërlikuara, të paqarta kaotike si sot.

Dhe kjo situatë, sepse kalimi nga shoqëria e vjetër, me bazament totalitar përcaktues dhe me strukturë sociale armiqësore, në shoqërinë me format urban, në thelb liberal-demokrat të individualizuar, e perceptuar “shqiptarçe”, është arsyeja që ka sjellë ndryshime esenciale në jetën urbane, sidomos në marrëdhëniet e njeriut me shoqërinë, marrëdhënie që duhen vlerësuar seriozisht.

Megjithëse, në pikëpamje strategjike, rruga e ndërtimit të shoqërisë së lirë, ndryshimet që kanë ndodhur në jetën urbane, në natyrën e shoqërisë dhe të njeriut, duken dhe përgjithësisht janë për mirë, por në thelb, pas saj fshihet kaosi i jetës që ka kaluar dhe i asaj ku ndodhemi, kaos që vazhdon të ndodhë me intensitet të veçantë në shoqërinë e sotme shqiptare. Për shkak të ndryshimit të tipologjisë së jetës ende nuk janë të qarta idetë konceptuale, ndërsa strukturat sociale, që e ndihmojnë njeriun të ndërtojë raporte normale, humane midis komponentëve të jetës së tij urbane, qoftë publike a private, nuk janë të stabilizuara. Sidomos shqetësuese është situata kur vjen fjala për vlerësimin e shpërpjesëtimeve të thella që ka në çështjen e vlerësimit të gabuar të “unitetit” dhe “ndarjes” së jetës të njeriut modern, në raport me “veten” dhe me nevojën e ndërtimit të marrëdhënieve midis “pjesës publike” dhe “pjesës private”.

Nuk është e vërtetë të besojmë se situata e jetës sociale e urbane aktuale është e tëra e lidhur me të kaluarën e hidhur, ose me faktin që ne kemi ardhur nga një shoqëri me marrëdhënie të totalizuara, në të cilën jeta publike ishte plotësisht sociale, dhe pjesa e jetës private nuk ekzistonte. Në të vërtetë, e kaluara është një “haraç” që ka koston e vet në tranzicionin social dhe moral të shoqërisë sonë. Por tani nuk mund ta fshehim gjithçka që ndodh pas së kaluarës, ne duhet të gjejmë dhe të ndajmë mes nesh përgjegjësitë e reja, në mënyrë që të lehtësojmë kushtet që të ndërtojmë raportet normale të jetës sonë urbane e të qytetëruar.

Pas problemeve të jetës së përditshme empirike, gjithnjë qëndrojnë shumë pengesa, vështirësi dhe kontroversa konceptuale të perceptimit qytetar të raporteve të reja, midis jetës publike dhe pjesës së jetës private të njeriut. Në vështirimin filozofik dhe sociologjik të realitetit, duhet të pranojmë se qytetarët tanë kanë shumë probleme në ndërtimin e marrëdhënieve të qytetëruara me veten dhe me shoqërinë, sepse kanë vështirësi konceptuale dhe reale, jo vetëm për të dalluar qartë “kufirin” që ndan pjesën e jetës publike dhe jetës private të njeriut, por sidomos kur tentojnë të gjejnë “modulet e reja” që përcaktojnë ndarjen e segmentit kompleks të elementeve të jetës urbane, sociale dhe private të njeriut.

Kjo çështje nuk është problem teorik, por së pari ajo është çështje e madhe e jetës sonë, që te njerëzit të krijohet koncept i drejtë veprues për vendin dhe rëndësinë që ka sidomos pjesa e jetës private të njeriut, si pjesë me rëndësi e jetës intime. Është e rëndësishme dhe shqetësuese për ndërtimin e qytetërimit tonë, që shumë njerëz, në “emër të lirisë personale”, kanë filluar të shpërdorojnë jetën private, duke mos vlerësuar aspak faktin e rëndësishëm, që përderisa njerëzit jetojnë në shoqëri dhe janë qenie sociale, nuk mund të jenë asnjëherë të shkëputur prej saj, pasi njeriu nuk mund të jetojë humanisht pa siguruar lidhjen e domosdoshme të “jetës private” me parimet e përgjithshme të jetës urbane e publike.

Ne duhet të pranojmë se duke jetuar në suazën e shoqërisë liberale postmoderne, natyrshëm që do të ndihen defektet e mungesës së këtij korrelacioni, që shfaqet dukshëm në deformimin e marrëdhënieve urbane, sociale, private, publike dhe intime të njeriut. Sepse në këtë kohë në modelin e jetës urbane të shoqërisë tonë, pjesët e segmentit të jetës socio-private dhe private-intime nuk janë në harmoni të plotë.

Është gjë shumë pozitive, element me rëndësi emancipuese, fakti që te ne ka filluar të kristalizohet qartë jo vetëm ideja e nevojës së “kufirit ndarës” midis komponentëve të jetës publike dhe elementeve të jetës private të njeriut, por dhe vlerësimi i veçantë i pjesës së jetës intime, e

cila ka të bëjë me thellësinë e intimitetit individual, me relacionet krejt të veçanta që njeriu realizon me persona të tjerë jashtë jetës publike, duke pasur garanci që ajo të rrjedhë në zona të caktuara e lirë dhe pa kontroll social të “privatësisë humane”.

Por kjo nuk justifikon njëanshmërinë, që është shndërruar në kontradiktën e madhe “shoqëri-individ”, e cila po shoqërohet nga tentativa këmbëngulëse për të ndarë dhe për të vendosur “kufijtë” e kësaj “jete të trefishtë” të njeriut (si raport midis jetës urbane publike-private-intime). Sepse shumë njerëz, meqë janë të mërzhitur nga vaniteti i modelit social të jetës në të kaluarën, janë të vendosur të shkëputen me çdo çmim nga kjo tipologji e “jetës sociale” duke vlerësuar, madje më saktë, duke mbivlerësuar vlerën e jetës private, e cila ka filluar, për fat të mirë, të konceptohet nga shumica e shqiptarëve si esencë dhe thelb i jetës postmoderne.

Në modelin aktual të jetës urbane shqiptare më shumë flitet për konceptin e jetës private dhe konceptin e privatësisë së njeriut, por pa pasur ndërkohë një koncept të drejtë, të balancuar midis saj dhe pjesës së jetës publike. Shpërpjesëtimet janë të dykahshme. Edhe koncepti i vjetër, që në emër të socialitetit dhe sociabilitetit, i jep të drejtë ndërhyrjes së të tjerëve (individë ose struktura) në jetën private të individit, por edhe koncepti reduksionist i disa njerëzve, që në emër të jetës private, intime nuk pranojnë asnjë lidhje a interferim ndikues të jetës urbane e sociale në jetën e tyre, nuk është ndihmues për qytetërimin tonë.

Këto nuk janë njëanshmëri teorike, por koncepte të deformuara, që kanë ndikim negativ, i cili po sjell pasoja sociale të dukshme në jetën e shoqërisë shqiptare. Kjo po ndodh se në jetën e përditshme punojmë pak, prandaj ka shumë paqartësi strukturore për të ndarë atë pjesë të jetës së njeriut, që është publike, nga pjesa e jetës që është private, e përveçme, intime. Personalisht, mendoj se sidomos deformim dhe shformim ka marrë ajo pjesë që ka lidhje me konceptin dhe me ndjenjën e intimitetit njerëzor.

Tani është imperative të fillojmë të rivendosim disa ekuilibra sociale në këto “dy pjesë” të jetës urbane e private të njerëzve tanë. Së pari, duhet t’i mësojmë fëmijët dhe të rinjtë, tek të cilët, për shkak të moshës ky deformim shfaqet më hapur, që intimiteti nuk është thjesht ndjenjë e mbylljes në vetvete, e cila barazohet me izolimin e njeriut nga jeta shoqërore. Nëse këtë ndjenjë do ta interpretojmë në mënyrë të tillë, do të thotë se e kemi kuptuar fare thjesht. Është e vërtetë që në kushtet e qytetërimit postmodern, jeta intime është shumë e rëndësishme, pse brenda saj janë, siç thonë sociologët, “burimet kryesore” të jetës së njeriut, sepse aty rrjedh jeta personale me të gjitha veçoritë e trupit dhe të shpirtit.

Por jetë private nuk do të thotë jetë e mbyllur, e izoluar nga shoqëria, jetë pasive vegetative. Jeta private nuk është “ekzistencë e mbyllur” dhe e ngërthyer në vete, e “mbrojtur” dhe e veçuar nga të gjitha marrëdhëniet sociale. Njeriu është qenie me “natyrë të dyfishtë”, që ka të bashkuar në një të vetme pjesën e sjelljes në raport me shoqërinë, që është pjesa e jetës publike dhe pjesën private të lidhur me tipologjinë e personalizuar të jetës intime.

Në fakt, duket se në shoqërinë shqiptare ka një tendencë mekaniciste, një reagim antikolektivist agresiv që ndikon në ekzagjerimin artificial të “kufirit” të pjesës së jetës intime në dëm të pjesës publike. Kjo, e interpretuar si e drejtë që vjen në emër të lirisë së njeriut. Zmadhimi i këtij deformimi ontologjik të jetës është bërë “sëmundje sociale” për jo pak njerëz, të cilët, ngaqë për shkaqe të ndryshme kanë ndërprerë marrëdhëniet me jetën sociale, kanë filluar të shenjtërojnë jetën e mbyllur në “intimitete perverse”, duke i vënë asaj etiketën e jetës private, duke e parë atë pa lidhje dhe komunikim publik, pa kërkesa dhe relacione sociale.

Nuk ka vlerë jeta private kur ajo bëhet te njeriu “pjesë e tepërt” ose kur reduktohet në “mbetje jete” pa vlerë sociale, që krijohet nga fakti se disa njerëz kanë gjetur si rrugë personale tërheqjen nga detyrimet sociale për shkak të vështirësisë dhe pengesave që ka orientimi i suksesshëm në jetën publike.

Të mbyllesh në jetën intime, nuk do të thotë se po bën jetë të pasur personale a private. Jeta e mbyllur në “burgun e privatësisë”, është braktisje e detyrimeve jetësore që ka njeriu për të realizuar detyrat humane e urbane në çdo pozicion qoftë. Ky qëndrim asocial i theksuar po përcakton një rrudhje të fortë të koncepteve urbane, ideve dhe praktikave komunitariste, që janë “stabilizatorët” e jetës morale e sociale, që garantojnë nevojën e koherencës dimensionale të jetës publike dhe private të njerëzimit tanë. Në jetën e përditshme, por edhe në shumë tekste e botime shkollore, hidhen ide simpliste që të sjellin në mendje koncepte sociale të deformatuara, që ngatërrojnë dimensionet e pangjashme, madje të kundërta të “jetës komunitare” dhe “jetës totalitare”.

Sigurisht, duke ndërtuar një shoqëri moderne, e cila nuk ka frikë nga “thelësitë shpirtërore” të jetës private të njeriut, nuk mund të mos shqetësohemi që në anën tjetër, ideja e ekzagjerimit të kufirit të jetës private ka filluar të ketë pasoja serioze në jetën e njerëzve tanë. Teprimi me madhësinë e privacisë ka filluar të japë kundërefekte sociale negative, deformime të jetës individuale të shumë njerëz, që barazojnë “jetën private” me idenë e gabuar të “izolimit social”, të shkëputjes së marrëdhënieve me realitetin dhe me grupet komunitare.

Fakti që po shtohen njerëzimit e mbyllur në “kutinë e shtëpisë” së vet, që bëjnë jetë vanitoze, pa ide dhe pa relacione urbane e sociale, po krijon një shtresë që ka filluar të ndihet e izoluar pikërisht ngaqë bën një jetë pa natyrshmërinë e duhur urbane e sociale. Jeta e mbyllur në privatësi, e ndarë me “thikë” nga jeta urbane dhe nga marrëdhëniet sociale, është në të vërtetë fillimi i një procesi të ndërlikuar të sëmundjeve individuale dhe sociale, të cilat e kanë bazën kryesore, pikërisht në deformimin mekanik të raportit të jetës publike, private dhe intime të njeriut.

Në këtë “trekëndësh” të jetës urbane, të parë si raport i ri midis sferës private dhe pjesës intime, është vendosur jeta e bukur, por aty janë dhe rreziqet e patologjive sociale, dëmtimeve mentale që burojnë nga “jeta e izoluar” e individit, nga perceptimi i gabuar i raporteve

humane midis këtyre pjesëve të jetës. Nuk është e lehtë që të vendosen raporte të drejta, të gjenden paradigma proporcionale të jetës së suksesshme, të cilat kërkojnë ndërtimin e “arkitekturës së jetës” të çdo njeriu. Megjithatë, kanë të drejtë filozofët e modernitetit, se ajo që i duhet shoqërisë dhe njeriut, është që ata “... të çlirojnë jetën private nga mistifikimet, duke mos lejuar që ajo të bëhet një privilegj apo mbrojtje kundër jetës shoqërore¹”.

Elita urbane dhe “ofiçi i qytetarit”

Në përpjekje për të rindërtuar në trajtë postmoderne jetën urbane, gjëja e parë që duhet të mendojmë dhe ta besojmë bashkërisht si shqiptarë, është të pranojmë të vërtetën e njohur, se përfundimisht nuk mund të ecim përpara në këtë rrugë të gjerë të qytetërimit bashkëkohor, nëse mendojmë se atë mund ta arrijmë nëpërmjet spontanitetit të zhvillimeve lineare apo, aq më pak, duke u mbështetur në “trajektoren e vjetër” urbane të qytetërimit tonë. Nuk ka dyshim që zhvillimet në këtë fazë kërkojnë tjetër mënyrë të perceptimit, tjetër koncept të vlerësimit të vlerës qytetare të qenies njerëzore. Qoftë kur ata duam t’i shikojmë si qytetarë individualisht të zakonshëm, por që së bashku duhet të përbëjnë elitën urbane të vendit tonë.

Në këtë kontekst duhet të jemi të ndërgjegjshëm që, për shkaqe të caktuara të traditës historike dhe defekteve aktuale, koncepti ynë për elitën qytetare ende nuk e ka identitetin e plotë, nuk ka gjetur kuptimin e duhur, normalitetin e përbërjes qytetare dhe të stratifikimit urban e social si shtresë e vlerësuar e qytetarisë shqiptare. Koncepti i elitës qytetare ka nevojë të interpretohet ndryshe nga konceptet e ngushta të elitave të tjera, qoftë politike, intelektuale, akademike ose kulturore.

¹ Emanuel Mounier, “Personalizmi”, Tiranë, 2005, f. 68.